



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, (relatore znj. Irena Plaku).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Mary Kate Butterfield dhe Klodiana Vogli, përfaqësues të OPDAT-it.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar kolegë!

Paraprakisht, ju bëj me dije që zonja Llagami nuk e ka të mundur të jetë prezent në këtë mbledhje për shkak të angazhimeve profesionale të saj, dhe për këtë arsye mbledhja e ditës së sotme do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari, Ilir Rusi.

Gjithashtu ju bëj me dije që për shkaqe shëndetësore, zoti Hallunaj do të jetë në lidhje “online” në këtë mbledhje. Ndërsa anëtarët e tjerë janë prezent në këtë mbledhje.

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sipas rendit të ditës, kemi përcaktuar seancë dëgjimore në lidhje me magjistratin {...} për tre procedime, një të nisur në vitin 2022 dhe dy të nisura në vitin 2023. Për

shkak të komunikimit të vazhdueshëm dhe për shkak edhe të rrethanave të deritanishme ku nga zoti {...} është paraqitur raport mjekësor në mënyrë të vazhdueshme/të pandërprerë, nga administrata njoftohemi që verbalisht është komunikuar që ai është pajisur me raport mjekësor nga institucioni përkatës mjekësor (sepse raporti i mëparshëm i përfundonte në datën 4 qershor të vitit 2023). Meqenëse sot jemi me datë 6 dhe ai ende nuk është paraqitur, por nga komunikimi verbal shprehet që në një periudhë të shkurtër kohore të ditës së sotme unë do të paraqes raportin mjekësor.

Meqenëse sot në rendin e ditës janë përcaktuar edhe pika të tjera, do të kërkoja efektivitet dhe objektivitet për vazhdimin e këtyre seancave dëgjimore të magjistratit z. {...}, dhe për shkak edhe të paraqitjes së përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të cilët janë në ambientet e jashtme të kësaj mbledhjeje. Do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që në vijueshmëri të mbledhjes ne të vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, sipas kronologjisë së tyre, me qëllim që ne t'i japim kohë z. {...} për të paraqitur ose konkretizuar atë çfarë i ka pohuar verbalisht administratës.

Jeni dakord që të kalojmë në një pikë tjetër të rendit të ditës?

Atëherë, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë dakord që të vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, dhe njëkohësisht do t'i kërkoja administratës të njoftonte përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për këtë rrethanë objektive, për të cilën ne nuk po fillojmë me pikën përkatëse të rendit të ditës (pikën 1, 2 dhe 3) që kanë të bëjnë me seancat dëgjimore të z. {...}, për shkak se jemi në pritje të paraqitjes së shkakut për të mos u paraqitur në mbledhje ose nuk do kemi shkak të tillë.

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës, është pika katër e saj që është shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}. Për të është përgatitur relacioni përkatës nga zonja Plaku. Njëkohësisht ju bëj me dije që zotit {...} i është komunikuar ky njoftim për shqyrtimin e kësaj pike në rend dite dhe nga komunikimi postar me të është shprehur që ka kërkuar ndjesë për mospjesëmarrje në datën e sotme. “I qëndroj kundërshtimeve me shkrim dhe me e-mail në adresën zyrtare. Nuk mund të marrë pjesë, sepse jam angazhuar si gjyqtar i gatshëm ditën e sotme, të

katër masave të sigurimit personal si dhe gjykimeve të tjera pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Duke ju falënderuar, ju uroj punë të mbarë.”

Ky ishte citimi i asaj çfarë ka shkruar në postë elektronike zoti {...}.

Për më tej fjalën ia jap relatores, znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes projektraportin e vlerësimit të gjyqtarit {...}, i cili do pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur. Gjithashtu do paraqiten në mënyrë të përmbledhur edhe kundërshtimet e paraqitura nga gjyqtari.

Gjyqtari është njoftuar rregullisht për projektraportin, ka depozituar si në rrugë elektronike ashtu edhe nëpërmjet postës kundërshtimet e tij, të cilat janë depozituar në datë 08.05.2023 pranë KLGJ-së.

Projektraporti i vlerësimit është për periudhën e gradimit, që përfshin vitin 2013 – 2016. Gjatë kësaj periudhe, gjyqtari {...} ka kryer detyrën në dy gjykata: në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku ka kryer stazhin, si dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Janë administruar aktet që i përkasin dosjes së rivlerësimit, si dhe janë përzgjedhur edhe 6 dosje të tjera, si dhe janë marrë të gjitha burimet e tjera të vlerësimit.

Në pjesën e parë të projektraportit, përveç procedurës, pasqyrohen përshkrimi i dosjeve të përzgjedhura me short, që janë pjesë e raportit analitik të vlerësimit, të hartuar nga KLGJ-ja në kuadër të vlerësimit dhe që janë marrë në konsideratë në pjesë të ndryshme të raportit.

Po kaloj tek kriteret e vlerësimit, konkretisht tek kriteri i parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, konkretisht në treguesin “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm ose konfliktin e normave”. Është konstatuar përgjithësisht se gjyqtari identifikon qartë rrethanat dhe faktet e çështjes si dhe ligjin e zbatueshëm. Janë konstatuar disa mangësi për sa i përket këtij treguesi. Në përfundim është arritur në konkluzionin se aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur

elementët procedurale lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe në disa raste të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të natyrës së mosmarrëveshjes.

Në përfundim është arritur se gjyqtari për këtë tregues duhet të pikëzohet me nivelin e vlerësimit “mbi mesatare” me 20 pikë.

Konkretisht për këtë tregues është konstatuar se jo në të gjitha çështjet gjyqtari pasqyron qartë rrethanat e çështjes, pasi në një vendim mungon tërësisht pasqyrimi i fakteve të çështjes, megjithëse gjyqtari për këtë tregues ka paraqitur kundërshtime. Edhe në kundërshtimet e tij ka cituar pikërisht këtë vendim duke thënë se ka pasqyruar rrethanat dhe faktet. Në kundërshtimet e tij ai thotë që pala paditëse në çështjet civile ka për objekt korrigjimin e akteve të pronësisë dhe tek pjesa tjetër ka thënë “pala paditëse pretendoi” dhe “pala e paditur pretendoi”. Nuk ka asnjë pasqyrim të fakteve as tek pjesa e parë, megjithëse ka një titull “rrethanat dhe faktet”.

Në disa vendime gjyqësore rrethanat dhe faktet janë pasqyruar në mënyrë sistematike duke referuar dhe provat, ndërsa në disa vendime pasqyrimi i fakteve nuk referohet tek provat përkatëse të cilat kanë rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Për sa i përket identifikimit të ligjit konstatohet se përgjithësisht gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm duke cituar dispozitat konkrete të cilat gjejnë zbatim, në rastin konkret, si në dispozitat materiale ashtu edhe procedurale.

Për sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes konstatohet se gjyqtari identifikon natyrën e çështjes, por nuk konstatohet e njëjta vëmendje e gjyqtarit në identifikimin e natyrës së çështjes apo analizën sa i përket juridiksionit dhe kompetencës, aq më tepër kur në dy vendime, konkretisht në dy vendime “pavërtetësi shënimesh”, gjyqtari në arsyetimin e tij pasqyron faktin që përbën një akt administrativ por në asnjë

pjesë të vendimit nuk ka analizuar kompetencën dhe juridiksionin kur në disa vendime të tjera këtë fakt e ka analizuar.

Për këtë arsye është arritur në konkluzionin se aftësia e tij për këtë tregues është “mbi mesatare”.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” – Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përgjithësisht bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari. Por jo gjithmonë konstatohet një analizë e tillë, pasi në disa raste, gjyqtari nuk bën një interpretim abstrakt të normës konkrete të referuar në disa raste bën vetën interpretim abstrakt të normës pa bërë një në raport me faktet konkrete të çështjet. Normat ligjore përmenden ose citohen duke u shoqëruar përgjithësisht me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Gjyqtari, në disa vendime burim vlerësimit, sidomos tek vendimet e zgjedhura prej tij, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Por nuk i kushton të njëjtën rëndësi arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, të cilat jo gjithmonë shoqërohen me interpretim të ligjit konkret apo me interpretimin e normave në funksion të rrethanave të çështjet.

Në këtë analizë ku janë identifikuar normat konkrete, janë identifikuar edhe vendimet përkatëse ku gjyqtari nuk konstatohet që të ketë identifikuar, domethënë të ketë analizuar ligjin e zbatueshëm.

Konstatohet përgjithësisht në disa vendime bën një analizë të tillë, ndërsa në disa vendime mungon një analizë e tillë por mjaftohet vetëm me citimin e dispozitave të ligjit dhe në konkluzionin përfundimtar pa bërë dhe një analizë mbi fatet e çështjes.

Konstatohet se gjyqtari përgjithësisht ka përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë.

Në konkluzion, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet

civile dhe penale. Konstatohet se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe procedural, duke bërë si interpretim abstrakt të normave por edhe duke i integruar ato me provat e paraqitura, por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimin e ligjit në çështjet civile ashtu dhe në çështjet penale. Në disa vendime burim vlerësimi, interpretimi i ligjit nuk është bërë në zbatim të rrethanave dhe fakteve të konkrete dhe në disa raste dispozitat janë cituar pa bërë një analizë abstrakte dhe konkrete të tyre. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe standardet ndërkombëtare të drejtësisë për të mitur të sanksionuara në aktet ndërkombëtare si dhe ka treguar kujdes për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket “Arsyetimit ligjor”, “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, nga analiza e vendimeve për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues jo jurist, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, ku janë përdorur përgjithësisht të gjitha germat e gjuhës shqipe. Vendimet janë të ndara me nënndarje apo nëntituj identifikues, dhe këto të fundit janë të ndarë në paragrafë. Por jo gjithmonë konstatohet se paragrafët kanë lidhje logjike me njëra tjetrën duke e bërë vendimin jo gjithmonë lehtësisht të kuptueshëm. Kjo pasi konstatohet se mendimi juridik kalon nga një pjesë në tjetrën e më pas kemi përsëritje të analizës së koncepteve juridike apo paragrafë që duken të futura në një pjesë që ndërpresin rrjedhën logjike analizës.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine.

Gjyqtari përgjithësisht përdor fjali me gjatësi mesatare dhe disa herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi në kuptueshmërinë e vendimit.

Në disa vendime përfundimtare burim vlerësimi gjyqtari pasqyron elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, ndërsa në disa vendime nuk konstatohet të pasqyrohen këto elementë, çka tregon se jo të gjitha vendimet e gjyqtarit ndjekin të njëjtin logjikë arsyetimi. Në vendimet burim vlerësimi përgjithësisht pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat përgjithësisht merren në analizë nga gjyqtari në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, herë pas here, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, duke vijuar, në disa raste në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, i jep qartësi elementëve të gjykimit.

Në konkluzion, referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

Sa i përket treguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”. Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë përgjithësisht të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale (jo në të gjitha vendimet) dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmblyllje procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek përgjithësisht metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese –arsyetuese.

Është bërë një analizë e secilës pjesë çfarë është konstatuar në secilin nga vendimet burim vlerësimi. Referuar sa më sipër, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të mirëorganizuar të vendimit (megjithëse nuk konstatohet e njëjta strukturë në të gjitha vendimet burim vlerësimi), e cila është e

dukshme në aspektin e përmbajtjes dhe atë vizual, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë përgjithësisht të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin.

Referuar sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në vendimet e arsyetuara rezultojnë përgjithësisht një nivel i mirë i arsytimit duke shqyrtuar dhe argumentuar përgjithësisht elementët që gjyqtari ka vlerësuar si të rëndësishme apo të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe elementët e vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Arsyetime të vendimeve përfundimtare, pas përshkrimit të fakteve të çështjes me natyrë procedurale dhe materiale përgjithësisht zhvillohet mbi bazën e një analize logjike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal, të zbatueshëm, duke integruar këto elementë në shumicën e rasteve edhe me faktet e çështjes të provuara në gjykim, duke referuar edhe aktet provuese të vlerësuar të rëndësishme, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të tij.

Në disa vendime burim vlerësimi, rezultojnë kujdes i gjyqtarit për të identifikuar dhe analizuar koncepte ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes, duke u marrë edhe me trajtimin juridik të koncepteve të së drejtës, duke orientuar me pas analizën e faktit dhe të ligjit në funksion të mbështetjes së konkluzioneve lidhur me bazueshmërinë ose jo të padisë, të kërtimeve të palëve në çështjet penale.

Në pjesën tjetër të vendimeve burim vlerësimi nuk rezultojnë njëjtë shkallë kujdesi në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore të koncepteve dhe të dispozitave të zbatueshme si ato me karakter procedural dhe material, megjithëse janë cituar nga gjyqtari, dhe në aspektin e argumentimit logjik, pasi komponenti analitik bazohet vetëm në arritjen e konkluzionit përkatës pa e analizuar atë në raport me rrethanat dhe faktet konkrete të përshkruara përgjithësisht në mënyrë të qartë në pjesën e parë të vendimit, dhe si gjejnë zbatim dispozitat përkatëse në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Në disa raste nuk bëhen një analizë juridike e koncepteve apo dispozitave përkatëse që gjejnë zbatim, por konkludohet direkt bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, dhe në disa raste konstatohet se bëhet një analizë e shkurtër e koncepteve juridike, por ato nuk analizohet në raport me rrethanat e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak-pasojë, megjithëse referuar rrethanave dhe fakteve ka qenë e nevojshme të analizohet, duke bërë kështu që vendimi jo gjithmonë të vijë si një i tirë në rrjedhë logjike.

Arsyetimi i vendimeve gjyqësore përgjithësisht është i qartë dhe i plotë dhe përgjithësisht merr në analize dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqese duke i analizuar ato, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, në tërësi si pjesë e analizës tërësore mbi zgjidhjen e çështjes. Por në disa vendime, arsyetimi jo gjithmonë është i qartë dhe i plotë edhe në raport me analizimin e të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve si në aspektin e analizës juridike të koncepteve ashtu edhe në raport me rrethanat dhe faktet konkrete të çështjes, ku gjyqtari pas një analize të përmbledhur të koncepteve lidhur me padinë apo barrën e provës, apo të elementëve të veprës penale, del direkt në konkluzionin përkatës lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Në disa vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore përgjithësisht zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura.

Më pas janë përshkruar analiza të cilat janë konstatuar në vendimet gjyqësore burim vlerësimi.

Në konkluzion, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport me natyrën çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi mesatare në këtë tregues, pasi në disa vendime burim vlerësimi, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe në disa raste janë referuar edhe qëndrime të praktikës gjyqësore, megjithëse nuk spikat interpretimi individual i ligjit. Përgjithësisht gjyqtari i

kushton rëndësi në analizë të pretendimeve të palëve, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjen e procedurës ashtu dhe për themelin e zgjidhjes së saj. Megjithatë, duke i vlerësuar vendimet burim vlerësimi në tërësinë e tyre, nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizë dhe argumentit logjik, si në lidhje me çështjet e procedurës ashtu dhe të themelit, pasi në një pjesë të vendimeve mungon komponenti analizës juridike të ligjit të zbatueshëm, dhe në disa vendime megjithëse i është bërë një analizë koncepteve të së drejtës apo të ligjit të zbatueshëm, mungon ndërthurja e këtyre koncepteve dhe interpretimi i ligjit të zbatueshëm në raport me mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet konkrete. Gjithashtu edhe pse konstatohet se disa vendime janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkesat e palëve, të cilat marrin përgjigje, kjo e fundit jo gjithmonë bazohet në një vlerësim të pavarur të pretendimeve të ngritur bazuar në ligjin përkatës që gjen zbatim dhe faktet konkrete të çështjes, duke dalë direkt në konkluzionin për bazueshmërinë ose jo të kërimit.

Sa më sipër, për këtë tregues, vlerësohet se aftësia e tij është mesatare duke e pikëzuar me 15 pikë.

Kështu propozimi për kriterin “Aftësia profesionale e gjyqtarit” është 77 pikë, “Shumë mirë”.

“Aftësia organizative e gjyqtarit”, konkretisht “Respektimi i afateve ligjore”, duke qenë se për këtë tregues gjyqtari nuk ka kundërshtime, ka rezultuar se referuar dosjeve burim vlerësimi nuk rezulton që të ketë ndonjë çështje jashtë afatit ligjor. Për këtë arsye është vlerësuar aftësia e tij “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Plotësimi i standardeve minimale”, janë analizuar të gjitha çështjet burim vlerësimi, duke evidentuar afatin për secilin prej tyre. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 12 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor.

Sa më sipër vlerësohet se në lidhje me këtë tregues, aftësia e gjyqtarit është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij jashtë standardit është 0%.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, nga analiza e burimeve të vlerësimit, konkretisht vendimeve për të cilat zbatohen standardet minimale, është

konstatuar se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi minimal për të gjithë kategoritë e çështjeve.

Për këtë arsye, vlerësohet se aftësia e tij për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, është konkluduar se rendimenti i gjyqtarit është 82%. Megjithatë është bërë edhe një analizë tjetër e të gjitha burimeve të vlerësimit, të dhënave statistikore. Duke qenë se gjyqtari ka gjykuar në dy gjykata, ku në Gjykatën e Tiranës ka rezultuar rendimenti i gjyqtarit 87%, ndërsa në Gjykatën e Kurbinës 78.17%. Megjithatë po të përjashtojmë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose po ta konsiderojmë atë 100% duke qenë se ky i fundit nuk ka qenë i mundur të përfundojë çështjet në afat për shkak se ka mbaruar periudha e stazhit, rezulton se nga bashkimi 100% i rendimentit të Tiranës, nëse do ta konsiderojmë të tillë, me rendimentin e Gjykatës së Rrethit Kurbinës është 78.17%, rezulton 87%. Ndërsa rendimenti i përbashkët (po të marrim 87 me 78), rezulton me 80% , përqindje kjo e cila sipas metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 6 pikë.

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarit të standardit sasior në fuqi, rezulton si më poshtë. Është bërë një përshkrim i numrit të çështjeve të gjykuara nga ana e gjyqtarit, çështje me palë kundërshtare dhe jo me palë kundërshtare dhe ka rezultuar se gjyqtari ka gjykuar rreth 180 çështje civile në themel në një periudhë 1 vit e 3 muaj, duke gjykuar kështu nën standardin sasior, ku në 1 vit duhet të gjykonte 200 çështje themeli.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton me 81%. Referuar metodologjisë së pikëzimit, referuar numrit të çështjeve të shqyrtuara prej tij, faktin se ky gjyqtar ka gjykuar edhe 57 çështje masa sigurimi (të cilat janë me afat ligjor). Gjithashtu rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari për periudhën shtator 2015 – dhjetor 2016 ka qenë i deleguar edhe në gjykata të tjera ku ka përfunduar 9 çështje si relator dhe 15 çështje si anëtar i trupit gjykues, duke e bërë atë të pamundur për të qenë në gjykatën ku ushtron detyrën në datat e zhvillimit të seancave. Për sa më lart, megjithëse rezulton se rendimenti është i ulët, është vlerësuar që pikëzimi i tij të bëhet me 6 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore” – Referuar burimeve të vlerësimit, në projektraport janë pasqyruar e gjithë koha që janë depozituar në kryesekretari vendimet gjyqësore. Referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve është më e shkurtër për të gjitha kategoritë e çështjeve. Për sa më sipër, edhe për këtë tregues, rezulton se aftësia e gjyqtarit është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore”, “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”. Edhe në këtë projektraport janë pasqyruar numri i seancave për secilën çështje dhe shkaqet që kanë çuar në shtyrjen e tyre dhe që janë përshkruar edhe në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit.

Janë shikuar edhe numri i seancave të cilat kanë qenë me vonesë ose jo.

Referuar sa më sipër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, është propozuar pikëzimi i tij me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” - Gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore menjëherë ose deri në 12 ditë pas caktimit të çështjes me short. Seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Për çështjet e përfunduara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin të gjitha seancat janë të regjistruara në audio përveç një çështjeje, por edhe këtu është relatuar shkak, për shkak të sallave të lira.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke urdhëruar njoftimet përkatëse për palët. Përgjithësisht drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligjin për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet

civile ashtu edhe në kërkesën penale apo në çështjen penale të themelit. Ndërsa në dosjen penale që i përket vendimit nr.673–110–124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është konstatuar vendimi dhe procesverbali i shqyrtimit të kërkesës për vleftësim arresti, caktim mase sigurimi personal, si dhe gjykim të drejtpërdrejtë për dy të pandehur, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar në nenin 236/2 të K.Penale, kërkesë e cila është shqyrtuar në një seancë, për të cilën më pas është dhënë një vendim i përbashkët, në kundërshtim me parashikimet e nenit 245 të K.Penal në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës.

Gjithashtu është relatuar edhe vendimmarrjet e gjyqtarit, të cilat përgjithësisht kanë rezultuar të rregullta (vendimmarrjet e ndërmjetme).

Referuar sa më sipër vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues është “mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 16 pikë.

“Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore” – duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për këtë tregues pasi ka rezultuar se aktet e dosjes janë renditur në mënyrë që janë lehtësisht të aksesueshme.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit”, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë në këtë tregues, për këtë arsye propozohet pikëzimi i tij me 10 pikë.

Niveli i pikëzimit për kriterin e “Aftësisë organizative të gjyqtarit” është “Shkëlqyeshëm”, me 92 pikë.

Për sa i përket “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, ka rezultuar që aftësia e gjyqtarit për secilin nga këto tregues është shumë e lartë, për këtë arsye është propozuar një nivel i përgjithshëm i pikëzimit me 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, për sa i përket “Komunikimi i qartë dhe transparent” rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i tij me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, nuk rezulton që të ketë ndonjë të dhënë lidhur me këtë tregues.

Për sa më sipër vlerësohet se shkalla e aftësisë së tij është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët” – edhe për këtë tregues, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta. Një rrethanë e tillë rezulton edhe për treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore”. Për këtë arsye, për secilin nga këto tregues është propozuar aftësia e tij shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë (*dhe 15 treguesi tjetër*).

“Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues...” rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës, në trajnime. Konkretisht ai ka marrë pjesë në 15 aktivitete të zhvilluara në Shkollën e Magjistraturës të zhvilluara në 27 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë.

Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët...” – nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë. Për këtë arsye, referuar metodologjisë së pikëzimit, gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

“Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale...” – referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton angazhim i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale. Për këtë arsye, duke qenë vlerësimi për të gjithë gjyqtarët fillon me 3 pikë, gjyqtari do të vlerësohet me 3 pikë pasi nuk provohen veprimtari të tij.

Referuar “Publikimeve ligjore”, referuar dosjes së gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë botuar botime shkencore.

Po kaloj direkt tek kundërshtimet e fundit.

Gjithsesi do i përmend edhe kundërshtimet e para.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e tij duke referuar se

ka një publikim në vitin 2013 dhe një botim në vitin 2015, por nuk kishte paraqitur prova deri në këtë moment.

Në këtë moment, pasi është kontaktuar me gjyqtarin sepse në faqet ku ai ka referuar (të internetit), nuk rezultonte botimi i tij në vitin 2015 (pasi botimi i vitit 2013 nuk i përket periudhës së vlerësimit pasi ishte i qershorit, dhe jo vetëm kaq por edhe gjatë viteve të studimit të tij në magistraturë). Në këtë moment gjyqtari ka vendosur në dispozicion, të fotokopjuar, një botim të botuar në Revistën “Jeta juridike”, revista juridike shkencore, me nr. 9, dhjetor 2015, ku ka një botim së bashku me gjyqtarin tjetër Sokol Pina.

Referuar sa më sipër, propozoj që për këtë tregues, duke qenë se rezultojnë të dhëna për publikime nga gjyqtari, të pikëzohet me 5 pikë.

Kështu, për kriterin e fundit, propozimi është 96 pikë (nga 91).

Po përmbledh disa kundërshtime të gjyqtarit.

Gjyqtari ka paraqitur kundërshtime duke referuar burimeve të vlerësimit. Konkretisht ka pasqyruar konstatimin dhe analizën e çështjeve burim vlerësimi, konkretisht pjesën përshkruese, të cilat dua të theksoj që është vetëm pjesë përshkruese dhe atyre të cilat janë konstatuar, ndërsa analiza bëhet tek pjesa tjetër dhe nuk rezulton që të ketë ndonjë kundërshtim për sa i përket në rast se janë përshkruar ose jo drejt këto dosje.

Për sa i përket “Aftësive për identifikuar...” gjyqtari ka paraqitur kundërshtime konkretisht për “Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm ose konfliktin e normave”. Ka referuar pikërisht atë vendimin që unë e citova pak më sipër, ku ka pretenduar që ka relatuar rrethanat e fakteve, por po të shikosh atë që ka cituar por dhe vendimmarrjen, del qartë që gjyqtari nuk referuar asnjë rrethanë dhe fakt, por ka pretenduar së përbën fakt vetëm objekti i padisë së paraqitur nga ana e palës paditëse dhe “paditësi pretendoi”. Por nuk rezulton asnjë provë.

Tek analiza ligjore lidhur me këtë vendim, i cili në fakt është referuar edhe nga gjyqtari, gjyqtari ka arsyetuar se bazuar në provat shkresore të sjella nga paditësja, që janë certifikatë përkatëse të pronësisë dhe provat me ekspert që i bashkëngjitet aktit, kur nuk rezulton asnjë e dhënë lidhur me këto prova. Pas shqyrtimit në tërësi të provave,

kjo është analiza e fundit e gjyqtarit, dhe analizës juridike, ku jemi para faktit të certifikatës së pronësisë që nuk pasqyron realitetin në lidhje me gjendjen juridike në raport me posedimin faktik, ardhur si pasojë e gabimeve në aplikimin e vetë këtyre shtetasve, pasi janë në marrëdhënie të posaçme (të afërm, vëllezër dhe motra), janë gabime të zyrës përkatëse, përsëri gjykata çmon se duhen korrigjuar në mënyrë që të pasqyrohet e vërteta në këto dokumente. Kjo është analiza, pasqyrimi i fakteve të gjyqtarit.

Më pas, po në kundërshtimet e tij ka parashikuar edhe pjesën urdhëruese të vendimit.

Më pas ka bërë edhe një kundërshtim për sa i përket një mase sigurimi, e cila është evidentuar nga ana ime që nuk është bërë pasqyrimi i rrethanave dhe fakteve por vetëm janë cituar provat, janë listuar se nuk janë cituar. Por në përfundim gjyqtari thotë që këto të meta të konstatuara në vendimmarrje, nuk mund të çojnë në vlerësimin tim mbi mesatar por duhet të vlerësohet shumë i lartë, etj.

Po i pasqyroj në mënyrë të përmbledhur duke qenë se i kemi dërguar të gjitha kundërshtimet.

Për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin”, lidhur me këtë vlerësim, gjyqtari çmon se (citet): Në arsyetimin e vendimit përfundimtar i është kushtuar vëmendje e duhur analizës së provave, duke arsyetuar faktin e provuar nga secila provë dhe në tërësi, faktet e provuara nga secila palë dhe më tej është bërë interpretimi abstrakt i normës së zbatueshme, në funksion të zgjidhjes së çështjes. Kam vlerësuar se vendimi përfundimtar i gjykatës nuk është vendi i duhur për të kryer interpretime abstrakte që nuk i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, por interpretimi abstrakt është bërë gjithnjë në funksion të zgjidhjes së çështjes, kur sidomos kjo normë ka vend për diskutim, - duke cituar edhe dispozitat të cilat ka cituar. Në fakt unë këto dispozita i kam cituar në projektraport por kam relatuar që nuk është bërë asnjë arsyetim lidhur me këto dispozita, janë cituar dhe në përfundim gjyqtari ka arritur në konkluzionin përkatës lidhur me padinë.

Po ashtu thotë (citet): Theksoj se nuk konstatohet problematika për interpretimin e dispozitave procedurale civile apo penale përfshirë kuptimin e padisë, referuar nenit 32/c, lidhur me padinë e pavërtetësisë së një dokumenti, në lidhje me

aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante apo parimet e përgjithshme të së drejtës, duke i cituar shprehimisht apo herë duke iu referuar kontekstit të arsytimit apo analizës ligjore.

Lidhur me përfundimet e arritura në këtë tregues, çmoj se interpretimi paraprak i normës është bërë në çdo vendim civil apo penal. Është vlerësuar që ky interpretim abstrakt të mos jetë i zgajtur dhe t'i shërbejë zgjidhjes së çështjes konkrete, duke mos tejkaluar në interpretime që nuk janë në funksion të çështjes, duke u bërë në mënyrë më sintetike në çështjet civile për të arritur nga normat që i shërbejnë parimeve të përgjithshme që janë trajtuar në mënyrë sintetike, pa iu bërë një interpretim abstrakt dhe duke iu bërë një interpretim më i detajuar normave konkrete që i shërbejnë edhe zgjidhjes së çështjes.

Gjyqtari pretendon që në të gjitha vendimet ka bërë një arsyetim ligjor të dispozitave por në projektraport janë analizuar vendimet përkatëse në të cilat është konstatuar një gjë e tillë dhe vendimet në të cilat nuk është konstatuar një analizë e tillë, por është mjaftuar vetëm duke arsyetuar për shembull natyrën e çështjes.

(Citohet) Në tërësi, mbështetur në kundërshtimet e parashtruara, vlerësoj se disa nga mangësitë e konstatuara në projektraport, lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes nuk qëndrojnë dhe nuk janë të tilla, që të tregojnë nivel mbi mesatar për këtë tregues. Por thotë, aftësia ime për këtë tregues është shumë e lartë duke kërkuar pikëzimin maksimal.

Gjithashtu gjyqtari ka paraqitur kundërshtime edhe për treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”. Po lexoj disa paragrafë.

(Citohet) Duke marrë për bazë edhe në raportin për analizimin e aftësive profesionale në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe faktin që vendimet nuk janë copy-paste i njëra-tjetrës e ndryshojnë për nga rëndësia, natyra, kategoria civile, problematikës dhe pretendimeve të palëve, ku ligji dhe rrethanat e çështjes analizohen të integruara në pjesën përshkruese – arsyetuese duke u shkrirë në një, kujdesshëm, që vendimi gjyqësor në çdo rast të jetë i organizuar e i kuptueshëm për gjykatat më të larta dhe për publikun e palët që i drejtohet, pasi përdor metodën IRAC, që përfshin faktet e çështjes, faktet e nevojshme dhe jo ato të panevojshme, ligjin dhe normat ligjore të zbatueshme për

zgjdhjen e konfliktit, duke përdorur fjali të shkurtra, të qarta, formën veprorë të fjalive, fjali me gjymtyrë të plotë, paragrafë të shkurtër me tri apo katër fjali të ndara njëra-tjetra për t'u lexuar thjesht dhe me numra apo shkrim romak për të orientuar lexuesin. Për këto arsye vlerësoj se aftësia ime në këtë tregues është shumë e lartë.

Në projektraport është pasqyruar qartë për sa i përket përdorimit të rregullave drejtshkimore, është i qartë vendimi, por janë konstatuar paqartësi të paragrafëve nga njëri-tjetri.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, lidhur me këtë tregues, gjyqtari ka paraqitur kundërshtime, ka paraqitur pretendime, por në fakt lidhur me këtë tregues gjyqtari është vlerësuar me pikët maksimale.

Për sa i përket “Cilësia dhe argumenti logjik”, gjyqtari ka kundërshtuar duke pretenduar se: (citohet) Duke marrë për bazë edhe në raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe faktin që vendimet nuk janë copy-paste i njëra-tjetrës e ndryshojnë, vlerësoj të theksoj se përmbajtja e normës së zbatueshme është përfshirë në arsyetimin e vendimit përfundimtar duke përfshirë në vendim atë pjesë të normës që ka qenë e zbatueshme në rastin konkret dhe jo të gjithë përmbajtjen e normës për atë pjesë të saj që nuk ka qenë e zbatueshme. Kjo mënyrë citimi apo referimi tek norma ligjore është një rregull i shkrimit dhe arsyetimit ligjor ku në vendimet gjyqësore apo dokumentet e tjera ligjore nuk është e nevojshme që të përfshihet ajo pjesë nuk është e zbatueshme apo objekt i dokumentit ligjor. Për rrjedhojë, theksoj se përmbajtja e normës së zbatueshme është e përfshirë. – Në fakt nuk e kam cituar në përmbajtjen e raportit faktin që nuk janë cituar dispozitat por ky tregues merret me cilësinë e analizës dhe argumentit logjik, domethënë si interpretohen dhe zbatohen këto dispozita si në interpretimin abstrakt, ashtu edhe në raport me rrethanat e çështjes.

Konkretisht më pas gjyqtari kundërshton duke thënë se: (citohet) Interpretimi abstrakt i tyre, në çdo rast, vendim me objekt zgjidhje martesë apo në marrëdhëniet e punës do të përbënte interpretim teorik të këtij instituti, gjë që ka qenë e panevojshme për vendimin përfundimtar e nuk do t'i shërbente qartësisë e konsicizitetit të arsyetimit siç është rasti i analizimit të kriterëve për caktimin e dënimit për dy të pandehurit së bashku sepse vepra penale është kryer në bashkëpunim.

– Sepse është evidentuar që gjyqtari në disa vendime, për shembull vendimi zgjidhje martese, në fakt kishte një analizë shumë të mirë në krahasim me vendimet e tjera dhe është bërë edhe një interpretim teorik. Ky interpretim nuk është bërë në raport me faktet e çështjes. Konstatohet që përgjithësisht tek vendimet nuk i kushton të njëjtën rëndësi, për shembull tek një vendim penal gjyqtari ka analizuar, ka marrë interpretimin për sa i përket kriterëve për caktimin e masës së dënimit për të dy të pandehurit së bashku, kur në fakt dënimi është individual.

Gjithashtu nuk i përgjigjet për shembull të gjitha pretendimeve të palëve, ku në një vendimmarrje penale janë kërkuar të dy pezullimi i dënimeve, në një vendim është arsyetuar se për njërin të pandehur pranohet, ndërsa për të pandehurin tjetër nuk referohet asnjë e dhënë dhe pse është pranuar apo duhet rrëzuar kjo kërkesë.

Si përfundim, këto janë kundërshtimet e gjyqtarit.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale” – Në fakt gjyqtari lidhur me këto kundërshtime ka paraqitur faktin që nuk duhet marrë në konsideratë fakti se ai ka filluar disa seanca me vonesë për shkak se ka qenë edhe në gjykimet e tjera dhe numri i çështjeve janë identifikuar në projektraport, ku rezultonte se kishte qenë (në mos gaboj) në 15 gjykime si anëtar dhe 9 gjykime si relator. Janë evidentuar dhe nuk i janë ulur pikë për këtë fakt, por janë ulur pikët për shkak se është konstatuar se në një vendim gjyqtari ka marrë masën e sigurimit, ka zhvilluar seancën për masën e sigurimit për ty bashkë të pandehur, kur ligji në fuqi e ndalonte shqyrtimin e tyre në një seancë.

Për sa i përket publikimeve ligjore, siç e cituam më sipër, gjyqtari ka referuar në dy “site” (sajte), konkretisht “magjistratura.edu”, është bërë verifikimi. Nuk konstatohet asnjë e dhënë lidhur me publikimin e tij, por më pas gjyqtari vuri në dispozicion para seancës, pasi u kërkuar publikimi i tij ligjor, për këtë arsye u propozua pikëzimi i tij me 5 pikë. Unë i qëndroj propozimit, përveç propozimit të fundit, publikimeve ligjore, të cilat kërkoj që të pikëzohen me 5 pikë, pasi rezulton publikimi i tij. Faleminderit!

Po bëj një përmbledhje për secilin kriter dhe pikëzimin përkatës.

Propozimi për “Aftësitë profesionale të gjyqtarit është 77 pikë, “Shumë mirë”; “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, 92 pikë, "Shkëlqyeshëm"; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm"; “Aftësia personale dhe angazhimi

profesional”, nga 91 pikë, propozohet 96 pikë; dhe propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është 365 pikë, "Shumë mirë", duke qenë se për një kriter vlerësimi i tij ka rezultuar “Shumë mirë” dhe jo "Shkëlqyeshëm".

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatorja?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Unë jam dakord me raportin e vlerësimit dhe me atë çka parashtron relatorja. Kam vetëm një vlerësim ndryshe, një mendim ndryshe në lidhje me “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”. Në vlerësimin tim, për këtë nënkriter, gjyqtari duhet të vlerësohet jo 15 pikë pra në nivelin mesatar, por mbi mesatar – 20 pikë. Ky është propozimi im. Pra të shtohen 5 pikë tek “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Pra zonja Shehu, tek kriteri i përgjithshëm “Aftësitë profesionale”, tek nënkriteri përkatës “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, nga 15 pikë, e cila u relatua nga relatorja, ju propozoni vlerësimin në nivelin e 20 pikëve.

Ka diskutime, propozime të tjera?

Ju lutem, keni diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime të tjera, zonja Plaku, si relatore, keni për të thënë diçka?

Irena Plaku: Unë i qëndroj projektraportit të vlerësimit.

Kam konstatuar që niveli i analizës nuk është mbi mesatare, referuar edhe të gjithë vlerësimeve të mëparshme që kemi bërë. Siç e kam relatuar në projektraport disa vendime janë të arsyetuara, ndërsa në disa vendime mungon tërësisht analiza juridike e çështjes. Gjithsesi është në vlerësimin e Këshillit.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime dhe propozime të tjera, kalojmë fillimisht në hedhjen për votim të propozimit të zonjës Shehu, që tek kriteri i përgjithshëm i “Aftësive profesionale”, tek nënkriteri “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, magjistrati zoti {...} të vlerësohet nga 15 në 20 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër (*Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por i kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar (citoj): “saktë... kundër”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Kundër.

Nuk miratohet propozimi i zonjës Shehu.

Ilir Rusi: Kështu që hedhim në votim projektvendimin e paraqitur nga zonja Plaku sipas relatimit të saj.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e OPDAT-it).

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 6.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023).

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023).

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

² Këto çështje ishin parashikuar të trajtoheshin si pikë e parë, e dytë dhe e tretë sipas rendit të ditës. 24

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Mimoza Koçiu, përfaqësuese e ILD-së.*
- 6. {...}, {...} dhe {...}, përfaqësues të ILD-së.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 8. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 6.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023).

3. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023).

4. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me shqyrtimin e pikave të tjera të rendit të ditës, ato të cilat ishin përcaktuar të parat në rang kronologjik, pikat 1, 2 dhe 3 që kanë të bëjnë me seancat dëgjimore të zotit {...}, sepse ndërkohë që zhvilloheshe kjo pikë e rendit të ditës, nga administrata gjyqësore u njoftuam që ka ardhur komunikimi lidhur me paraqitjen e dokumentit nga zoti {...}, përmbajtjen e të cilit do ta prezantojmë përgjatë shqyrtimit të pikës përkatëse.

Do i kërkoja administratës të bëjë njoftimin e përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për t' u paraqitur.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Mirë se erdhët!

Sipas komunikimit të bërë nga administrata, ishim të një pritjeje të një konfirmimi verbal që kishte bërë zoti {...} në lidhje me pajisjen e tij me një raport mjekësor të vazhdueshëm, komunikim i cili erdhi.

Me këtë rast po vazhdojmë me seancat dëgjimore për tre procedimet disiplinore të nisura ndaj magjistratit {...}, me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, procedimi disiplinor nr. 3 i vitit 2022, nr. 1 i vitit 2023 dhe nr. 2 i vitit 2023.

Sipas autorizimeve të paraqitura, kemi një autorizim të ditës së sotme me nr. {...}, datë 05.06.2023, me të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë autorizon zonjën {...} dhe zotin {...}, me detyrë Inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët përfaqësojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor me nr. 3/2022, në ngarkim të magjistratit {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, që do zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor në seancën e datës 06.06.2023, ora 11:00, dhe të cilët janë prezent në këtë seancë.

Ndërkohë, në lidhje me përfaqësuesin tjetër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është autorizimi i datës 05.05.2023, në përmbajtje të të cilit nuk është përcaktuar se për kë seancë do merrni pjesë, kështu që prezumohet që është për të gjitha seancat në vijim. Më lejoni të lexoj përsëri autorizimin nr. {...}, datë 05.05.2023, për të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë autorizon z. {...} me detyrë Inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr. 1/2023 në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu edhe autorizimi nr. 1514, datë 05.05.2023, në të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë autorizon z. {...} me detyrë Inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr. 2/2023 në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në vijim të seancës së datës 8 maj 2023, në të cilën seanca u shty për shkak të mosparaqitjes nga ana e z. {...} për shkak të paraqitjes nga ana e tij të raportit mjekësor i cili kishte një kohëzgjatje deri në datën 04.06.2023. Me komunikimin verbal na ishte komunikuar që ai ishte pajisur në vijueshmëri me raport mjekësor por komunikimi

elektronik ka arritur tek posta jonë elektronike në datën 06.06.2023, ora 11:40 dhe ky ishte shkaku për të cilën pse këto seanca dëgjimore nuk vijuan në orën 11:00, thjesht për të konfirmuar këtë fakt, i cili në vijueshmëri të shqyrtimit të pikave të tjera të rendit të ditës, ky fakt i tillë u konfirmua, për të cilin edhe administrata jua ka vënë në dispozicion dhe ju ka bërë me dije.

Sipas këtij raporti mjekësor, paaftësia e përkohshme rishtazi e tij është për 15 ditë dhe ka filluar nga data 4.06.2023, ditë e diel, dhe përfundon në datën 19.06.2023 (ditë e hënë). Në datën 19.06.2023 është i aftë për punë, që është ditë e hënë.

Ndërkohë ju bëj me dije që të gjitha aktet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit për z. {...}, i është bërë me dije, edhe për seancën e sotme dëgjimore z. {...} ka marrë dijeni vetë personalisht duke firmosur aktet përkatëse, por në vijim ka paraqitur këtë raport mjekësor i cili nga institucioni përkatës mjekësor është lëshuar në datën 5 qershor 2023, pra ditën e djeshme, ditë e hënë.

Në vijim, për më tej, çfarë mendoni ju?

{...}: Përshëndetje!

Ne vëmë re që është e njëjta situatë procedurale, si në seancën e parë dëgjimore ku magjistrati subjekt hetimi disiplinor ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme, por nga ana tjetër, Këshilli është investuar për të trajtuar rastin e pamundësisë fizike dhe mendore të magjistratit subjekt hetimi, atëherë mbetemi në pritje të vendimmarrjes së Këshillit, për të vijuar më tej procesin, me qëllim për të vijuar edhe ne me kërkesat procedurale, për shkak sepse janë paraqitur tre procedime disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ka të tjera parashpresa apo kërkesa nga ana e përfaqësuesve?

Po, zoti {...}!

{...}: Dakord me kolegun për ato që sapo ai tha. Kështu që, në kushtet kur në bazë të nenit 36, pika 3, germa “c”, nuk u mor një vendim për deklarimin e mungesës dhe caktimin kryesisht të mbrojtësit, por u mor vendimi i seancës së kaluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të magjistratit {...}, jemi të detyruar të presim këtë rezultat dhe më pas, sikurse u tha, procedojmë njëkohësisht edhe me kërkesat e tjera me interesin e këtij procedimi administrativ disiplinor, që ka të bëjë me bashkimin e të tria hetimeve disiplinore dhe shqyrtimin e tyre në një procedim të vetëm.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime apo pyetje nga anëtarët?

Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Si relator i çështjes, në kushtet kur subjekti {...} është me raport për paaftësi të përkohshme në punë dhe bëhet i aftë për punë më datë 19.06.2023, nga ana tjetër në referim të nenit 67 jemi vënë në lëvizje, në mbledhjen e kaluar ky Këshill vendosi që të verifikojë mundësinë fizike dhe mendore të magjistratit, nëse është në gjendje të ushtrojë funksionin e tij si gjyqtar apo jo, i propozoj mbledhjes që seanca gjyqësore të shtyhet. Data e shtyrjes të jetë pasi fillon aftësia për në punë, datë 21 të këtij muaji, 21 qershor, në ora 10:00. Nëse është dakord mbledhja?

Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime mbi datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore të radhës, atëherë këtë proces dëgjimor e përfundojmë në këtë moment, duke e shtyrë për në datën 21 qershor, ditë e mërkurë, për të tria procedimet disiplinore, përkatësisht për procedimin disiplinor 3/2022, procedimi disiplinor nr.1/2023 dhe nr.2/2023. Pra datë 21 qershor, ditë e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Administrata të marrë masa për njoftimin e zotit {...}, për seancën dëgjimore të radhës. Është fakt që tashmë zoti {...} ka marrë dijëni personalisht vetë

për procedimin që keni filluar ju, njëkohësisht edhe për vendimmarrjen përkatëse që ka marrë Këshilli në lidhje me verifikimin e aftësive mendore dhe fizike.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Mirë u takofshim!

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

* * *

(Pikat 2, 3, 4 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...} (relator znj Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*
7. *{...}, gjyqtar.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...} (relator *znj Ukperaj*).

(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës dhe komunikimit të bërë, magjistrati zoti Rexhepi ka shprehur vullnetin për të qenë prezent në këtë mbledhje plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me shqyrtimin e projektraportit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni dhe në këtë mbledhje do të relatohet nga zonja Ukperaj. Për më tej fjalën *znj. Ukperaj*.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Përshëndetje gjyqtarit që është sot prezent në seancë dëgjimore.

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 vjen si rezultat i trajtimit me përparësi të akteve me dosjen e vlerësimit profesional që dërgohen në Këshillin e Lartë Gjyqësor nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit pasqyrohet procedura dhe qëllimi që ka ky projektraport vlerësimi. Burimet e vlerësimit përbëhen nga dy grupe. Grupi i parë i burimeve të vlerësimit është ai i përdorur në vlerësimin etik dhe profesional të kryer nga organet e rivlerësimit. Janë të listuara të gjitha burimet e vlerësimit në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit. Përbëhen nga dosjet, nga vendimet gjyqësore të përzgjedhura, të dhënat statistikore, të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit, formularin e vetëdeklarimit, etj. Gjithashtu në këtë grup, janë përfshirë edhe vendimet të cilat janë administruar nga organet e rivlerësimit kalimtar për efekt të ankesave apo edhe vendime të administruara kryesisht.

Në këtë kuadër, brenda akteve të dosjes me aktet e vlerësimit profesional, kanë rezultuar dy vendime të administruara. Është një vendim i vitit 2016 i cili sigurisht është brenda periudhës së vlerësimit, por ky vendim i cili është administruar në kuadër të trajtimit të ankesave nuk rezulton që të jetë trajtuar në mënyrë të posaçme, apo që nga organet e rivlerësimit të jenë konkluduar elementë që mund të përbëjnë të dhëna burimore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Pra thjesht është gjetur si një vendim në dosje, i paanalizuar. Ndërkohë, që një vendim tjetër është ai i vitit 2016 (janar 2016), vendimi nr. 175, i cili ka pasur për objekt ankim kundër vendimit për “zgjatjen e afatit të hetimit”. Ky vendim është administruar gjatë procesit të rivlerësimit dhe nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi shpjegohet (në relacion është pasqyruar në mënyrë më të detajuar), unë do të lexoj vetëm konkluzionin e organeve të rivlerësimit, ku kanë arritur në konkluzionin se: “Nisur nga sqarimet e subjektit mbi shkaqet e kohëzgjatjes së gjyqimit të kësaj çështjeje dhe ballafaqimit të tyre me procesverbalet e seancave gjyqësore, vërtetohen pretendimet e tij se kjo kohëzgjatje ka ardhur jo për shkak të veprimeve ose mosveprimeve nga ana e tij por për shkaqe objektive.”

Nga ana tjetër, për të njëjtën çështje rezulton që të jetë bërë edhe një relacion nga

ana e ish-inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilën do ta relatoj më vonë kur të vijmë tek kriteri përkatës.

Gjatë procesit të rivlerësimit rezultojnë të jetë administruar edhe një vendim i vitit 2019 (në fakt janë dy vendime të vitit 2019), por duke qenë se këto vendime pavarësisht se nga organet e rivlerësimit nuk janë gjetur elementë që mund të vlerësohen apo që afektojnë aftësinë etike dhe profesionale të gjyqtarit, nga ana tjetër këto dy vendime nuk janë vendime që i përkasin periudhës së rivlerësimit 2013 – 2016, janë vendime të 2019, dhe duke mbajtur edhe standardin që kemi mbajtur më herët, këto vendime nuk përbëjnë burim vlerësimi.

Burim vlerësimi përbëjnë edhe të dhënat e arkivuara nga burimet arkivore të ish-KLD-së apo të KLGJ-së. Nga verifikimet ka rezultuar që ka pasur dy ankesa gjatë kësaj periudhe. Një ankesë është verifikuar dhe është arkivuar për shkak se ka qenë e trajtuar më parë. Nuk është referuar që kjo ankesë të merret parasysh në vlerësimin etik dhe profesional. Ndërkohë që ankesa e dytë e verifikuar është pikërisht për atë çështje që organet e rivlerësimit (e citova më sipër) kanë dhënë konkluzionin e tyre. Kjo ankesë ishte verifikuar më parë nga Inspektorati i KLD-së dhe për shkak të trajtimit të kësaj ankese, referimi që kishte bërë Inspektorati në atë kohë ishte që kjo çështje duhet t'i merret parasysh gjyqtarit për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Është e vetmja çështje që është analizuar si burim vlerësimi në projektraportin e vlerësimit. Çështja ka të bëjë me ankimin ndaj vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit, kur rezultonte që në fakt çështja ishte regjistruar në shtator të vitit 2015 dhe ka përfunduar në 18.01.2016, pra periudha kohore ka qenë mbi 4 muaj.

KPK-ja lidhur me këtë situatë (pra kemi zgjatje të afatit të gjykimit në kushtet kur ligji parashikonte afat 10-ditor të trajtimit të çështjes), ka konkluduar siç ju relatova, që gjyqtari i ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes, për shqyrtimin e afatit të kësaj kërkesë, ndonëse zgjatja e afatit nga prokuroria ka qenë 3 muaj. Ndërkohë që e kundërta është argumentuar në raportin e inspektorëve. Inspektorët kanë konkluduar se në fakt gjyqtari nuk ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes. Ishin shtyrë disa seanca për kërkesat e mbrojtjes dhe disa seanca të tjera për mosparaqitje të prokurorit, dhe në konkluzion vendimi kishte qenë “shpallje moskompetence”, sepse duke

qëndruar 4 muaj, çështja kishte shkuar për gjykim dhe nuk mund ta shqyrtonte si gjyqtar i hetimit paraprak.

Duke qenë se kjo çështje është brenda periudhës së vlerësimit, analiza e detajuar e elementëve të saj që mund të afektojnë kritere apo indikatorë të caktuar të aftësive organizative, janë analizuar në vijimësi të këtij raporti për sa i përket të “numrit mesatar të seancave gjyqësore dhe kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, pra gjithmonë lidhur me aftësitë organizative të gjyqtarit.

Kjo ishte diçka që unë e vlerësova për ta cituar në mënyrë të veçantë sepse është i vetmi vendim i cili ka referim për t’u mbajtur parasysh për vlerësim etik dhe profesional. Në pjesën e parë të burimeve janë edhe të dhënat mbi pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese në periudhën e vlerësimit; Është raporti për analizimin e aftësive i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 14.02.2009 (*lapsus viti, pasi është 2019*) për efekt të organeve të vlerësimit; si dhe vendimi i KPK-së.

Grupi i dytë i burimeve të vlerësimit përbëhet nga gjashtë dosjet e përzgjedhura me short, përshkrimi i të cilave është bërë në mënyrë të detajuar në projektraport për sa i përket ecurisë procedurale të gjyqimit dhe elementëve të vendimit gjyqësor, janë gjashtë çështje, kryesisht çështje që janë trajtuar për efekt të gradimit, janë kryesisht çështje penale sepse ndoshta gjyqtari në atë kohë ka gjykuar si gjyqtar i seksionit penal.

Në vijim po vazhdoj me analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi.

Unë do doja fillimisht që të prezantoja projektraportin bashkë me gjetjet dhe në fund të shpreheshja për objeksionet që ka paraqitur gjyqtari sepse ato janë kryesisht në tërësi për kriterin e parë të aftësive profesionale dhe nuk janë të specifikuar për indikatorë përkatës.

Duke filluar me “Aftësinë profesionale të gjyqtarit”, aspekti i “Njohurive ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”. Vlerësoj me interes për të cituar edhe qëndrimin që Këshilli ka mbajtur në raportin ndihmës që ka përgatitur për organet e rivlerësimit. Ato pesë dosje dhe tre vendime gjyqësore janë bërë përsëri pjesë e rivlerësimit nga ana ime por gjithsesi, në

kuadrin e pasjes apo jo të nivelit minimal kualifikues nga Këshilli është arsyetuar se (nga raporti ndihmës që është përgatitur për KPK–në): “Gjyqtari ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 2 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor si dhe cilësimin e veprës. Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës dhe duke parashtruar pyetje të qarta për ta. Zbaton me korrektësi procedurën e gjykimit të shkurtuar. Ka njohuri të masave alternative të dënimit me burgim, identifikon rastet kur mund të vihet në zbatim pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim. Zgjidh drejt çështjet penale në gjykim dhe për pasojë, në disa raste, palët nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta. Në arsyetimin e vendimit në çështjen civile të analizuar nga subjekti nuk përdoren referenca ligjore materiale e procedurale civile dhe as në ligjin specifik “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe akteve nënligjore. Gjithashtu në çështjet penale në arsyetimin e vendimeve janë përdorur referenca në dispozitat përkatëse të ligjit material e procedural penal, por pa bërë ndonjë analizë juridike të tyre. Nga subjekti nuk përdoren në arsyetimin e vendimeve as referenca në praktikën e Gjykatës Kushtetuese apo vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, etj.”.

Çfarë ka rezultuar nga trajtimi i të gjitha vendimeve gjyqësore dhe dosjeve përkatëse që janë pjesë e procedurës së gradimit. Karakteristikë e gjyqtarit është prezantimi i rrethanave të çështjes në mënyrë koncize dhe të qartë, duke integruar provat përgjithësisht dhe kur është e nevojshme edhe pjesë të përmbajtës së tyre, në funksionin të dhënies së një panorame të qartë për faktin objekt gjykimi.

Duke u nisur nga mënyra se si inkorporohen rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (gjykim civil apo penal) apo llojit të këtij gjykimi, rrethanat e faktit parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese – arsyetuese të vendimit dhe dominojnë përmbajtjen e gjithë vendimit gjyqësor në raport me komponentët e tjerë të arsyetimit.

Pothuajse i gjithë vendimi gjyqësor dominohet nga përshkrimi i rrethanave të faktit.

Kujdesi që gjyqtari duhet të tregojë për përcaktimin e vlerës provuese të provave si dhe analizën e tyre në mënyrë të integruar me njëra – tjetrën, për të mbështetur konkluzionet mbi faktin penal/civil objekt shqyrtimi, nuk rezulton i dukshëm në çdo vendim burim vlerësimi. Në përgjithësi nga ana e gjyqtarit bëhet një paraqitje përshkruese e faktit penal ose civil objekt gjykimi, referohet në përmbajtjen e provave të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë por nuk rezulton në çdo rast një analizë e integruar e tyre me njëra-tjetrën dhe më vete apo përcaktimi i vlerës provuese në funksion të provueshmërisë së faktit për të cilin ato referohen.

Nga të gjitha burimet e vlerësimit, vetëm në dy vendime civile dhe në tre vendimet penale (ndërkohë që janë mbi 11 dosje për vlerësim), analiza e provave dhe përcaktimi i vlerës provuese të tyre është një element që ka marrë rëndësi të posaçme në arsyetim. Në vendimet penale të referuara kjo analizë bëhet në funksion të përcaktimit të elementëve të veprës penale dhe cilësimit juridik të saj, përgjegjësinë penale të të pandehurit në përputhje me provat e marra, etj. Në vendimet civile burim vlerësimi, paraqitja dhe analiza e provave të administruara, duke referuar edhe pjesë të përmbajtjes së tyre, bëhet në funksion të përcaktimit të natyrës së kërkimit objekt padie, por edhe kjo vetëm në disa vendime ose mund të themi vetëm në dy vendime civile.

Për sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, natyra e çështjes identifikohet edhe pse jo në mënyrë të shprehur. Kuptohet nga mënyra se si gjyqtari e trajton konfliktin.

Për sa i përket përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e çështjes por edhe me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari në përgjithësi e identifikon dhe/ose e citon ligjin e zbatueshëm, kjo referuar edhe natyrës së çështjes ku në disa raste, identifikimi i normës relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nuk rezulton që të jetë përcaktuar në mënyrë të shprehur (Me “footnotes” (futnots) janë të gjitha vendimet ku nuk gjen as ligjin të caktuar). Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, mund të themi se:

në vendimet civile (me objekt anulim akti, njohje vjetërsie në punë dhe saktësim i vendndodhjes së pronës), gjyqtari nuk ka identifikuar në pjesën përshkuese arsyetuese ligjin procedural dhe/ose material të aplikuar në zgjidhjen e çështjes. I vetmi referim ligjor është ai i nenit 93 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, referuar në kuadër të konkluzionit lidhur me plotësimin nga ana e paditëses të viteve të vjetërsisë në punë, pas njohjes së tyre nga gjykata.

Në vendimet penale, gjyqtari në të gjitha vendimet e themelit burim vlerësimi dispozitat identifikohen, por vetëm citohen, në funksion këto të vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit apo institutin e bashkëpunimit. Në projektraport janë pasqyruar (që mos t’i citoj nenet se edhe ngarkohet seanca) të gjitha nenet respektive të Kodit Penal, të pjesës së përgjithshme apo të posaçme, të identifikuara nga ana e gjyqtarit.

Lidhur me identifikimin e dispozitave procedurale, në çdo rast këto dispozita citohen, dispozita që kanë të bëjnë me gjykimin e shkurtuar apo uljen e masës së dënimit për shkak të aplikimit të këtij instituti. Gjithashtu citohen edhe dispozitat përkatëse lidhur me masat e sigurimit. Nuk konstatohet që të jetë evidentuar ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

Në tërësi, duke iu referuar të gjitha burimeve të vlerësimit (dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, vendimet gjyqësore, si dhe të gjitha akteve të dosjes së dërguar nga organet e rivlerësimit kalimtar, duke u bazuar edhe në atë çka është konstatuar edhe më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin konstatues ndihmës për organet e rivlerësimit) kam vlerësuar se gjyqtari në përgjithësi, por kryesisht tek vendimet penale, ka aftësi të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes si dhe identifikimit të normës/normave konkrete, kryesisht atyre me karakter material, që gjejnë zbatim në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes/çështjes. Ndërsa në pjesën tjetër të vendimeve (kryesisht vendimet civile), identifikimi dhe përcaktimi i ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes nuk rezulton të jetë referuar në arsyetimin e vendimit. Po ashtu, në paraqitjen e fakteve të

çështjes, dominon përshkrimi i fakteve dhe jo në të gjitha rastet rezulton të jetë bërë një analizë e vlerës provuese të provave mbi të cilat mbështeten fakteve përkatëse.

Për këtë arsye, për kriterin e parë “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” kam propozuar shkallën e aftësisë “mbi mesatare” dhe pikëzimin me 20 pikë.

Për të vazhduar me treguesin e dytë të kriterit të parë “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”. Nga burimet e vlerësimit, aty ku është identifikuar norma juridike dhe kryesisht ato penale, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, referimi apo citimi i normës bëhet në mbështetje të konkluzionit të arritur nga gjyqtari mbi ekzistencën e faktit penal, cilësimin juridik dhe përgjegjësinë e të pandehurit, si dhe me caktimin e dënimit, por nuk rezulton që këto dispozita t’i nënshtrohen një analizë apo zbërthimi paraprak, para përfshirjes së tyre në konkluzionin e arritur nga gjyqtari. Pothuajse në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi, normat ligjore thjesht referohen, pa u shoqëruar me interpretimin e tyre, por bëhet aplikimi i tyre direkt mbi faktet e çështjes.

Konkretisht, në vendimet penale burim vlerësimi, gjyqtari referon dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, pa bërë paraprakisht zbërthimin e saj sipas elementëve të figurës së veprës penale, apo kushteve dhe kriterëve të aplikimit të një instituti të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, sikurse është ai i bashkëpunimit, i pezullimit të ekzekutimit të vendimit dhe vënies së të pandehurit në provë, të cilët janë aplikuar në vendimet burim vlerësimi, pavarësisht se e ka shqyrtuar në tërësi çështjen. Pothuajse në të gjitha vendimet penale të themelit, për të mbështetur konkluzionin mbi llojin dhe masën e dënimit, gjyqtari referon nenet 48 dhe 49 të Kodit Penal në lidhje me rrethanat rënduese ose lehtësuese konkrete të rastit, apo nenin 59 në lidhje me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, por në asnjë rast nuk rezulton që këto dispozita t’i jenë nënshtruar një interpretimi apo zbërthimit të kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktin konkret.

Ndërsa në vendimet civile burim vlerësimi, në kushtet kur konstatohet mungesa e identifikimit dhe referimit të normës ligjore relevante për zgjidhjen e çështjes,

rrjedhimisht nuk rezulton të ketë as interpretim të ligjit por çështja është zgjidhur duke referuar dhe analizuar vetëm faktet konkrete të saj.

Për sa i përket aftësisë për të përdorur jurisprudencën relevante, nuk rezulton në asnjë rast që gjyqtari të ketë identifikuar apo përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve për interpretimin e ligjit material ose për zbatimin e tij.

Për sa i përket parimeve të përgjithshme të së drejtës ato zbatohen, pavarësisht se nuk përmenden në mënyrë të shprehur.

Konkluzion: Për sa i përket këtij kriteri, referuar të gjitha burimeve të vlerësimit, kam vlerësuar që gjyqtari ka një aftësi nën mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Interpretimi i ligjit procedural dhe atij material në zgjidhjen e çështjes është tepër i kufizuar dhe në disa raste mungon. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi dispozitat referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt në mbi faktet e çështjes, pa u bërë më parë një interpretim paraprak i tyre në drejtim të identifikimit të qëllimit të ligjit, elementëve përbërës dhe zbërthimit të tyre. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi dhe referimi në praktikën gjyqësore relevante, çka do t'i jepte vlerë të shtuar interpretimit të ligjit, në mbështetje të konkluzioneve të arritura mbi zbatimin e tij. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësi, rezulton se interpretimi dhe analiza e normave nuk reflekton një shkallë të lartë kujdesi në të gjitha vendimet pasi gjyqtari kryesisht referon dhe aplikon ligjin mbi faktet e provuara në gjykim, duke integruar referimin e dispozitave në konkluzionet e arritura, por nuk ndalet në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyeve konkrete për mënyrën e zbatimit të tyre mbi faktet e çështjes.

Për këtë arsye, aftësia e gjyqtarit për këtë kriter është vlerësuar nën mesatare, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Për sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, ky kriter (duke qenë se gjyqtari ka ngritur edhe pretendime në objeksionin e tij) ka të bëjë me mënyrën e të shkruarit se sa qartë është ajo që shkruhet (jo sa i qartë është vendimi), pra sa qartësisht shkruan gjyqtari. Në të gjitha vendimet në fakt, vendimet janë të qarta, të kuptueshme, janë lehtësisht të lexueshme jo vetëm për një lexues të arsyeshëm por edhe për njohësit e ligjit. Paragrafët janë të organizuar në rrjedhë logjike me njëri-tjetrin.

Nuk rezultojnë terma apo fjalë që mund të krijojnë paqartësi; respektohen rregullat e drejtshkrimit; përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së gjuhës së përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këtë arsye kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie lidhur me këtë tregues, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të njëjtë, të cilës i përmbahet në prezantimin dhe analizën e fakteve dhe lidhjen e tyre me konkluzionin e tij mbi zgjidhjen e çështjes, por nuk rezulton që pjesë e strukturës së vendimeve burim vlerësimi, në shumicën e tyre, të jetë interpretimi dhe analiza e ligjit të zbatueshëm, para apo gjatë aplikimit të tij mbi faktet e çështjes konkrete. Gjyqtari ka një metodologji të qartë duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Ato përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese–arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Pjesa përshkuese arsyetuese ndahet në disa nënpjesë (nuk janë përcaktuar me tituj por në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën) si: i) rrethanat e faktit ku rezulton përshkrimi i faktit i qartë dhe konciz si dhe referohen (citoen) provat pa i marrë ato në analizë me njëra-tjetrën;

(ii) paraqitjen e konkluzionit lidhur me zgjidhjen e çështjes dhe konkretisht në lidhje me a) ekzistencën dhe provueshmërinë e faktit penal, kualifikimin ligjor të tij dhe autorësinë e të pandehurit, duke u paraqitur kjo pjesë e arsyetimit me një ose dy paragrafë; b) bazueshmërinë ose jo të kërkimeve të palës paditëse në çështjet civile burim vlerësimi, duke u paraqitur kjo pjesë në formën e konkluzionit të shkurtër, në fund të pjesës arsyetuese të vendimit;

(iii) paraqitjen e rrethanave që ndikojnë në përcaktimin e dënimit për të pandehurit (në çështjet penale).

Referuar strukturës dhe përmbajtjes së arsyetimit të vendimit, rezulton se në arsyetimin e vendimit nuk elaborohet mjaftueshëm dhe nuk zë vendin e duhur në përmbajtje vlerësimi dhe analiza juridike e çështjes, pjesë në të cilën do të duhet të merrej në analizë ligji i zbatueshëm, zberthimi i tij, mënyrë e aplikimit mbi faktet e çështjes, për të derivuar më pas në konkluzionin e arritur.

Në pjesën e dispozitivit, dispozitivi është i qartë lidhur me deklarinimin fajtor në masën së sigurimit (në çështje penale). Në çështjet civile disponimi i gjykatës është i qartë lidhur me pranimin e kërkesë padisë, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj., duke përmbajtur të gjithë elementët e parashikuar nga neni 383/ç të K.Pr.Penale dhe 310 të K.Pr.Civile.

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të njëjtë të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre. Por nga ana tjetër në strukturën e pjesës arsyetuese, kalimi nga analiza e fakteve të çështjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, pa referuar dhe analizuar ligjin e aplikueshëm, ndikon në qartësinë dhe plotësinë e vendimit si dokument ligjor, jo për qartësinë e të shkruarit (për të bërë dallimin), pavarësisht se në dukje aspekti strukturor i ndërtimit të tij duket i qartë, por nuk mund të vlerësohet në të njëjtën mënyrë edhe për plotësinë e tij si dokument. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit nuk vlerësohet vetëm në aspektin formal të saj, por në thelb duhet të evidentohet edhe në aspektin përmbajtjesor, ku një strukturë e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar duhet të përmbajë të gjithë elementët e saj, në funksion të qartësisë, plotësisë, kuptueshmërisë së aktit. Për këtë arsye kam vlerësuar aftësinë e gjyqtarit “mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, nga ana e Këshillit, tek raporti ndihmës, kur është përgatitur për organet e rivlerësimit, është konkluduar se: “Në përmbajtjen e vendimit nuk rezulton analizë e kërkimeve të palëve dhe dhënia e përgjigjeve për to, në rastet kur është pranuar ose jo. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja mes fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve, ndonëse shumica e dosjeve penale janë me gjykim të shkurtuar, prej subjektit nuk i kushtohet ndonjë rëndësi e posaçme analizës së normës ligjore konkrete, prej tij nuk përdorën referenca, etj.” Gjithashtu është konkluduar se: “Ndonëse nuk ka pasur

vonesa në arsyetimin e vendimeve, duke qenë i përpiktë në zbatimin e procedurës penale apo civile, cilësia e arsyetimit të vendimit të tij është në nivelin mesatar.”

Çka rezultuar nga analiza në tërësi e burimeve të vlerësimit.

Burimet e vlerësimit, që janë vendimet gjyqësore, referuar kategorisë dhe objektit të mosmarrëveshjes apo çështjes së trajtuar, lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, paraqesin karakteristika të ndryshme.

Në vendimet penale, në përgjithësi gjyqtari nuk i ka kushtuar një rëndësi të posaçme analizës së faktit dhe provave të administruara, por mungon edhe përjasja e kësaj analize me ligjin e zbatueshëm, në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, përcaktimit të vlerës provuese të provave apo elementë të tjerë të rëndësishëm të cilat çojnë në mënyrë logjike dhe të natyrshme tek konkluzioni që arrin dhe paraqet gjyqtari mbi zgjidhjen e çështjes. Nuk rezulton e njëjta shkallë e vëmendjes sikurse për faktin penal, në drejtim të analizës dhe interpretimit të ligjit dhe dhënies së arsyeve mbi mënyrën e aplikimit të tij mbi faktin konkret, duke u mjaftuar me paraqitjen e konkluzionit se bazuar mbi këto prova dhe fakte, i pandehuri ka konsumuar veprën penale për të cilën ai akuzohet (pothuajse në të gjitha vendimet gjyqësore gjejmë këtë parashikim) por pa dhënë argumente se si është arritur në këtë konkluzion.

Në të njëjtën mënyrë, në pjesën e fundit të vendimeve penale të themelit, në lidhje me dënimin, vlerësimin e llojit dhe masës së dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative, gjyqtari i ka kushtuar rëndësi analizës së faktorëve të posaçëm që ka konsistuar në aplikimin e instituteve respektive, por nuk rezulton që të ketë marrë në analizë kushtet ligjore për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit apo bashkimit e dënimeve, duke i integruar ato me rrethanat konkrete të çështjes, në mënyrë që të evidentohen arsyet mbi konkluzionin e arritur lidhur me përshtatshmërinë e masës apo aplikimin ose jo të alternativave të dënimit me burgim.

Në vendimet civile, duke qenë se nuk evidentohen normat, nuk mund të flasim për një cilësi të lartë të analizës dhe argumentimit logjik.

Në drejtim të gjithëpërfshirjes, gjithashtu ka diçka që afekton vlerësimin e gjyqtarit, gjyqtari nëpërmjet vlerësimit të tij mbi zgjidhjen e çështjes, jo gjithmonë i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Kryesisht këtu kam cituar vendimin nr. 534, datë

06.5.2016 ku nuk rezulton t'i jetë dhënë përgjigje pretendimit të ngritur për mungesën e bashkëpunimit; vendimit nr. 1099, datë 16.11.2015 ku nuk rezulton t'i jetë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura për kryerjen e veprës penale sipas nenit 283/1 dhe jo 283/2, si dhe atij për moszbatimin e nenit 59 të Kodit Penal; në vendimin nr. 582, datë 09.06.2014, ku nuk rezulton t'i jetë dhënë përgjigje pretendimit të ngritur për kryerjen e veprës në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit. Në shumicën e vendimeve nuk rezulton që të jetë ndalur në mënyrë specifike në analizën e tyre, duke bërë një analizë e mirëfilltë ligjore mbi këto kërkimeve, e cila të jetë pjesë e procesit logjik nëpërmjet të cilit gjyqtari ka arritur tek bindja e brendshme.

Konkluzion: Analiza dhe argumentimi logjik, në rastin konkret, mbështetet kryesisht në analizën dhe vlerësimin e gjyqtarit mbi faktet e çështjes, duke bazuar konkluzionin për zgjidhjen e saj si deduksion të kësaj analize, por pa integruar dhe mbështetur këtë të fundit në interpretimin dhe dhënien e argumenteve mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktin konkret. Analiza jo e plotë, e detajuar dhe e integruar e provave në raport me ligjin e zbatueshëm, me qëllim evidentimin e faktit penal apo civil, nuk i jep cilësi të lartë analizës dhe argumentimit logjik. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, në raportin mes analizës së fakteve përballë ligjit të zbatueshëm dhe mënyrës së aplikimit të tij, rezulton se gjyqtari nuk ka treguar të njëjtën shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Procesi analitik i vlerësimit të provave dhe shkalla e interpretimit të ligjit të zbatueshëm edhe në drejtim të analizës së marrëdhënies shkak-pasojë, evidenton dukshëm një shkallë të ndryshme aftësie në lidhje me këtë tregues duke u dominuar vendimet burim vlerësimi nga elementi përshkruar në raport me atë analitik. Elementi gjithëpërfshirës i analizës së pretendimeve të ngritura nga të pandehurit në çështjet penale komplekse pothuajse mungon gjithashtu.

Për këtë arsye, për këtë tregues është mbajtur qëndrimi nga unë si relatore për shkallën e aftësisë nën mesatare. Pikëzimi me 10 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive profesionale”, niveli i vlerësimit që unë propozoj është “Mirë”, pikët 63.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”.

Të gjithë kundërshtimet e gjyqtarit lidhen me kriterin e parë. Duke qenë se nuk janë bërë kundërshtime lidhur me kriterin e dytë, po ndalem tek ato tregues të cilët kanë një problematikë të shfaqur.

Për sa i përket “Respektimit të afateve ligjore”, në fakt ka pasur vetëm dy çështje në të cilët ligji parashikon afat ligjor, një është respektuar (ka qenë një çështje që lidhej me caktim mase sigurimi), ndërsa një çështje tjetër nuk është respektuar afati 10-ditor i gjykimit (në mënyrë specifike përmendet në projektraport). Megjithatë, duke qenë një çështje e vetme, kam vlerësuar që nuk mund të kondicionojë të gjithë pikëzimin e gjyqtarit për këtë tregues dhe duke marrë parasysh edhe volumin e përbulluar nga ana e tij dhe treguesit e tjerë lidhur me standardet minimale dhe kohën mesatare të gjykimit, kam vlerësuar se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, prandaj duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor, diktohet nga kohëzgjatja vetëm e një çështjeje, për gjykimin me efikasitet dhe në kohë të së cilës gjyqtari ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme, përveç atyre që lidhen me disiplinimin e sjelljes së palëve në proces, që kanë përbërë shkak për kohëzgjatjen e shqyrtimit të tij. Por kjo gjetje ka reflektuar në një kriter tjetër pikëzimi nga ana ime, për të mos marrë pikëzimin maksimal. Lidhur me “Respektimin e afateve ligjore” propozohet pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardit minimal kohor”, nga analiza e të gjitha vendimeve dhe dosjeve gjyqësore ka rezultuar që përqindja e çështjeve tej standardit minimal ka qenë 7%, pra më pak se 10%. Pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” kam vlerësuar se ajo duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj ajo duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve” është 111.8%, sigurisht është me 10 pikë. Gjyqtari spikat për sa i përket aftësive organizative në evadimin e çështjeve.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit gjyqësor”, koha mesatare klasifikohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha

kategoritë e çështjeve. Janë të arsyetuara të gjitha brenda afatit. Pikëzimi është me 15 pikë.

Për sa i përket “Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, këtu tani ka ndikuar një çështje, ka qenë çështja që e relatova edhe më lart, lidhur me “Ankimin ndaj vendimit për zgjatjen e hetimeve”. Në fakt mesatarja e çështjeve gjyqësore në çështjet civile ka qenë 10.5 seanca, për çështjet penale ka qenë 3.2 dhe në total, numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.7 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale për shmangien e seancave joproduktive, rezulton se nga vëzhgimi i 10 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10-ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët, etj. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, si njoftimit i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, kryerja e akteve të ekspertimeve, njoftimi i ekspertit. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e tyre brenda 15 ditëve sipas parashikimit të nenit 342/2 të K.Pr.Penale. Megjithatë, në dy çështje burim vlerësimi, rezulton se gjatë gjykimit janë kryer veprime procedurale për marrjen e provave nga të tretët, apo lënien e kohës palëve për të paraqitur prova shkresore të vlerësuara të rëndësishme për gjykimin, ndërkohë që këto veprime mund të ishin kryer gjatë përgatitjes së çështjes për gjykim në veprime përgatitore. Në fakt është fakt që është konstatuar që nga raporti ndihmës për organet e rivlerësimit. Po ashtu në disa raste seancat gjyqësore janë shtyrë për të njëjtin shkak (për dhënien e kohës palëve për të paraqitur prova apo për dhënien e kohës shtesë për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare), pavarësisht se gjyqtari duket se ka marrë masat e nevojshme për përfundimin e gjykimit në një kohë të shkurtër, duke i caktuar seancat vijuese brenda afateve të shkurtra.

Lidhur me shkallën e aftësisë së gjyqtarit për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, pra bëhet fjalë për çështjen “Ankim ndaj vendimit për zgjatjen e afateve të hetimit”, në relacionin e inspektorëve të datës 29.01.2019 është konkluduar se: “.....pretendimi i ankuesve për zvarritje të gjykimit qëndron, pasi në rastin konkret rezulton një periudhë prej 4 muaj e 14 ditë që ka vazhduar ky gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe ky është në kapërcim të afatit 10-ditor të përcaktuar për këtë lloj gjykimi nga Kodi i Procedurës Penale. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga gjyqtari në këtë rast nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës... Gjyqtari nuk ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, për shqyrtimin brenda afatit të kërkesës ankimore, ndonëse zgjatja e afatit nga prokuroria ka qenë tre muaj. Pra shqyrtimi i kësaj kërkesë ankimore ka vazhduar edhe pas mbarimit të afatit të zgjatur, duke zhvlerësuar qëllimin për të cilin ishte ushtruar kërkesa ankimore nga ankuesi. Nga analiza e zhvillimit të seancave gjyqësore rezulton se pala ankuese nuk është paraqitur tre herë në gjykim, por edhe prokuroria si palë e interesuar nuk është paraqitur në katër seanca gjyqësore, duke sjellë si pasojë shtyrjen e seancave gjyqësore dhe zvarritjen e gjykimit. Janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 2 kanë qenë produktive.....”.

Nga KPK-ja lidhur me këtë çështje, është konkluduar se seancat gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes në gjykim të ankuesve dhe avokatit mbrojtës të tyre, por jo për shkaqe që varen nga gjyqtari.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca dhe gjyqtari jo në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave

që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka marrë të gjitha masat për planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë, por e njëjta shkallë aftësie nuk evidentohet për shmangien e seancave joproductive e zhvillimin e gjykimit me efektivitet.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numrit mesatar të seancave për secilën kategori çështjesh, dhe atë në tërësi, si dhe shkallës së kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet mesatare, sepse për çështjet civile, rezultojnë në mënyrë të përsëritur seanca të shtyra për të njëjtin shkak dhe moskryerje me efikasitet e veprimeve në seancë përgatitore. Ndërsa në çështjen penale të referuar “Ankim ndaj vendimit për zgjatjen e afateve të hetimit”, evidentohet një numër i lartë seancash joproductive (nga 10 seanca vetëm 2 produktive). Në këtë të fundit, pavarësisht nevojave procedurale që lidhen me ecurinë e gjykimit dhe pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit, rezulton se edhe pse pala ankuese nuk është paraqitur tre herë në gjykim dhe prokurori katër herë në gjykim, gjyqtari veç përsëritjes së njoftimit për palët, nuk rezulton të ketë marrë masa për njoftimin e Drejtuesit të Prokurorisë, apo caktimin e një mbrojtësi kryesisht. Për këtë shkak, gjykimi i çështjes ka tejkaluar vetë afatin e zgjatur të hetimeve, çështja penale ndërkohë është dërguar për gjykimin në themel të saj dhe gjyqtari ka disponuar në fund me shpalljen e moskompetencës tokësore duke ia përcjellë atë për vlerësim gjyqtarit të themelit.

Veprimet procedurale të nevojshme sigurisht që kushtëzojnë shtyrjen e seancave gjyqësore, por nuk janë ato që drejtojnë gjyqtarin. Administruesi i procesit nuk është Kodi i Procedurës, ai është mjet në dorë të gjyqtarit, i cili duhet të përdoret në mënyrë efektive. Nga ana tjetër cilësia e zgjidhjes së çështjes, nuk është tregues i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Tek kriteri i aftësive organizative, vlerësuesi nuk shqyrton ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjyqtarit në kuadër të procesit të rregullt ligjor, por aftësinë e gjyqtarit për të menaxhuar çështjen, në aspektin e përdorimit sa me efektiv të kohës dhe drejtimit të hetimit gjyqësor. Vlerësuesi nuk ndërhyr në çështje që lidhen me zbatimin e

dispozitive procedurale në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Sigurisht që ky i fundit nuk mund të përfundojë pa pasur një njoftim të rregullt të palëve, pa u respektuar e drejta e tyre për t'u dëgjuar, apo për t'u mbrojtur, sepse nëse këto të fundit nuk respektohen, potencialisht mund të shtrohen diskutime për shkelje disiplinore të gjyqtarit. Aftësia organizative e gjyqtarit shkon përtej kësaj. Gjyqtari duhet të organizojë procesin gjyqësor e të drejtojë hetimin gjyqësor, në zbatim të detyrimeve procedurale dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse, duke përfunduar shqyrtimin në një kohë sa më të shpejtë, duke disiplinuar dhe vetë ai, me urdhra dhe vendime, sjelljen e palëve në gjykim. Në kohëzgjatjen e gjykimit, veç sjelljes së palave, luan rol dhe mënyra se si gjyqtari drejton hetimin gjyqësor, duke iu dhënë zgjidhje pretendimeve të palëve në momentin e duhur procedural, pa shtyrë pafundësisht seancat gjyqësore, si në rastin konkret evidentohet në dosjet burim vlerësimi, ku seancat shtyhen disa herë për paraqitje provash apo për kryerje të aktit të ekspertimit (flasim për çështjet civile) edhe pse nevojshmëria e marrjes së tyre ka qenë evidente që në fillim të gjykimit.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, gjyqtari pikëzohet me 9 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, referuar akteve dhe burimeve të vlerësimit, evidentohet shkallë e lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të parashikuar për gjykimin penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara dhe ato përgatitore. Pikëzimi është me shkallë shumë të lartë aftësie, 20 pikë.

Për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes”, evidentohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi maksimal për të dy këta tregues.

Përfundimisht për kriterin e “Aftësive organizative” propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 94.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, në kushtet kur të gjithë treguesit e këtij kriteri bazohen në parimin e prezumimit dhe nuk ka pasur të

dhëna që mund të afektonin në një pikëzim të ndryshëm, është propozuar pikëzimi maksimal për të gjithë treguesit e këtij kriteri dhe përfundimisht, për kriterin e tretë propozohet pikëzimi me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Nivel i lartë i vlerësimit është propozuar edhe për aftësinë e komunikimit, komunikimin e qartë dhe transparent të gjyqtarit me kolegët dhe me administratën, respektimin e konfidencialitetit, aftësinë për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer njohuritë me kolegët, aftësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Për sa i përket "Pjesëmarrjes së gjyqtarit në programet e formimit vazhdues", është propozuar pikëzimi me 20 pikë, pasi këtë qëndrim e kemi mbajtur duke qenë se ligji nuk parashikonte periudhë minimale dhe njëkohësisht maksimale trajnimesh dhe për këtë arsye, qoftë edhe një trajnim i vetëm është vlerësuar nga ana jonë me 20 pikë. Nga ana tjetër, gjyqtari ka marrë pjesë gjatë periudhës së vlerësimit në tre trajnime të cilat përkojnë me 5 ditë trajnimi në të gjithë periudhën 3-vjeçare. Megjithatë, për shkak të arsyetimit që sipërcitova, duke qenë që ligji përcaktonte vetëm kufirin maksimal për 1-5 vjet dhe jo një kufi minimal detyrim paraqitjeje pjesëmarrje në trajnim, është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

Për sa i përket "Disponueshmërisë për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve", nuk ka pasur të dhëna. Pikëzimi me 3 pikë.

Për veprimtari ndërinstucionale, nuk ka pasur të dhëna. Pikëzimi me 3 pikë.

Për "publikime ligjore", nuk ka pasur të dhëna. Pikëzimi 0 pikë.

Për këtë arsye, për kriterin e katërt, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Lidhur me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit, në këtë rast, ndryshe nga të gjitha herët e tjera, në fakt ne nuk kemi pasur asnjë rast që njëri të ketë qenë në nivel "Mirë" dhe të tjerat të kenë qenë "Shkëlqyeshëm", por në Metodologji dhe në ligj është zgjidhur kjo situatë. Duke qenë se kriteri i vlerësimit të "Aftësive profesionale" është "Mirë" në këtë rast, niveli i vlerësimit nuk mund të tejkalojë këtë nivel vlerësimi edhe pse tre nivelet e tjera janë "Shkëlqyeshëm". Për këtë arsye është propozuar që niveli i përgjithshëm i vlerësimit është "Mirë" me 348 pikë.

Për sa i përket objeksioneve të paraqitura nga ana e gjyqtarit, në fakt bashkangjitur këtyre objeksioneve janë paraqitur edhe disa prova që gjyqtari kërkon të administrohen dhe të reflektohen edhe në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit, por këto prova në thelb nuk përbëjnë prova të reja sepse janë e gjitha pjesë e dosjes personale të gjyqtarit. Pra vlerësimet që ju keni sjellë, janë në fakt pjesë e dosjes personale tuaj dhe dosja personale përbën burim vlerësimi.

Lidhur me pretendimin që nuk është referuar në pjesën e parë të raportit vlerësimi 2005-2006, nuk është referuar për arsye sepse në raporte pasqyrohet vetëm vlerësimi i fundit i mëparshëm, jo vlerësimet e tjera që mund të ketë pasur gjyqtari. Megjithatë nëse ju doni në projektraportin tuaj ne mund ta pasqyrojmë edhe vlerësimin për 2005–2006. Në të dyja rastet, vlerësimi i gjyqtarit ka qenë “Shumë mirë”.

Për sa i përket kundërshtimeve nga ana e gjyqtarit, gjyqtari është vetë prezent dhe mund të ndalet në mënyrë më të hollësishme tek kundërshtimet e veta. Ajo që unë dua të theksoj në këtë rast është që në fakt e gjithë përmbajtja e kundërshtimeve të gjyqtarit ka të bëjë me atë se si duhet të jetë modeli i një vendimi gjyqësor i shkruar nga një gjyqtar. Gjyqtari ka specifikuar që vendimin gjyqësor e shkruan për qytetarët apo për palët që ka në proces. Nuk është e nevojshme që ta ngarkojë vendimin gjyqësor me shpjegimet e ligjit, me doktrinë, sepse e rëndësishme është që pala ta kuptojë përmbajtjen e vendimit gjyqësor. Kjo nuk do të thotë që vetë gjyqtari nuk është në dijeni të praktikës gjyqësore, të praktikës unifikuese të vendimeve të Gjykatës Evropiane apo të Gjykatës së Lartë, por qëllimi për të mos e ngarkuar vendimin gjyqësor me referime të tilla, ka çuar që këto vendime gjyqësore të jenë në këtë strukturë dhe në këtë përmbajtje që ato kanë. Në thelb nuk kundërshtohet asnjë nga gjetjet që janë bërë nga ana ime si vlerësuese.

Në objeksionet e veta ka paraqitur një dukje sikur ka kundërthënë midis konkluzioneve për qartësinë e vendimit dhe konkluzion lidhur me gjetjet për sa i përket kriterëve të tjera të aftësive profesionale, por unë e shpjegova që për sa i përket i përket kriterit të “Qartësisë, kuptueshmërisë...” ne vlerësojmë gjuhën dhe mënyrën se si shkruhet. Ndërsa kur bëhet fjalë për komponentë të tjerë të aftësive profesionale, që kanë të bëjnë me njohuritë ligjore, interpretimin e ligjit, zbërthimin e ligjit, analizën, ne vlerësojmë mënyrën se si ligji pasqyrohet në vendimin gjyqësor. Nga ana tjetër, në

objeksionet tuaja keni referuar që jeni frymëzuar nga mënyra se si vendimet e gjykatave të huaja shkruhen nga gjyqtarët pjesë e “common law” (*kamën lou*), ku ata nuk i referohen zërthimit të katër elementëve të veprës penale, etj., dhe duke qenë se ne përqipemi dhe kemi synim të aderojmë në bashkësitë e këtyre shteteve, je përpjekur që të ndjekësh të njëjtën strukturë të vendimeve të tyre.

Nga ana tjetër ke përmendur që norma e lartë e çështjeve të gjykuara sigurisht që ka ndikuar edhe në arsyetimin e vendimeve, keni gjykuar 1242 çështje për periudhën 2013-2016 dhe sigurisht që keni dy herë më shumë se norma që duhet të gjykojë gjyqtari.

Nga ana tjetër keni përmendur që të gjitha vendimet gjyqësore janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Keni dhe dy vlerësime të tjera, njëkohësisht tregoni edhe eksperiencën tuaj profesionale, që keni mbaruar fakultetin me mesatare 9.6, dhe në tërësi të tyre unë i përmbloodha, juve mund t’i jepni më të detajuara, kërkoni që të bëhet ndryshimi për sa i përket kriterit të “Aftësisë profesionale” nga “Mirë” në “Shumë mirë” dhe vlerësimi i përgjithshëm nga “Mirë” në “Shumë mirë”, pa specifikuar se për kë indikator keni kundërshtimet tuaja.

Në kushtet kur nga ana e gjyqtarit nuk është se janë paraqitur prova të reja që duhet të merren nga unë si relatore në vlerësim, por thjesht ai paraqet kundërshtime për mënyrën se si është bërë vlerësimi, në këtë moment nuk kam asnjë propozim, por të dëgjojmë gjyqtarin lidhur me kundërshtimet e tij.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, fjala është magjistratin, zotin {...}.

{...}: Ju faleminderit shumë njëherë për këtë çështjen, që gati gjysma e raportit diskutohet çështja. Bëhet fjalë për arrestimin e drejtorit të portit, zëvendës drejtori i portit dhe kryeinxhinieri i Portit të Durrësit, për tendera, për veprime të paligjshme dhe që s’lanë vend pa u ankuar, si e si që ta mbyllnin çështjen me të gjitha mënyrat, për ta penguar prokurorinë që të mos bënte hetimet dhe që në fund pastaj përfunduan në gjyq dhe morën dënimin që u takon. Këtë dua t’jua vë në dukje. Kjo duhet të ishte shënuar aty, pse ka ndodhur dhe si ka ndodhur. Nuk vinte prokurori në seancë gjyqësore. Ato

avokatët mbrojtës të atyre nuk vinin në seancë gjyqësore. Çfarë do bëjë gjyqtari? Më thoni ju, çfarë do bëjë gjyqtari? Por ama për të dalë ata dhe për të pushuar çështjen, këtë s'mund ta bëja kurrën e kurrës.

Për sa i përket problemeve të tjera... më vjen keq, sepse kjo çështje që në vitin 2015 është bërë tërkuzë, sepse u arrestua drejtori i portit, zëvendësdrejtori i portit dhe kryeinxhinieri i portit, se bënë tendera. Se drejtori i portit bënte tendera, kishte bërë firmën për nënën e vet. Kjo ishte për të vënë duart në kokë. Dhe ne diskutojmë këtu “kaloi tre ditë, kaloi pesë ditë”. Ai mori dënimin që i takonte; kryeinxhinieri mori dënimin që i takonte; nëndrejtori mori dënimin që i takonte. Dhe kështu duhen parë gjërat për mua si gjyqtar, se kam 44 vjet në drejtësi unë. Një vërejtje nuk kam marrë. Kam punuar në hetuesi, kam punuar në prokurori, e di ç'është hetuesia; e di ç'është prokuroria; e di ç'është prova; e di ç'është mekanizmi i ngjarjes; e di ç'është këqyrja e vendit të ngjarjes, se kam shkuar vetë, i kam bërë vetë.

Thuhet aty gjysma e raportit për ish-drejtorin (se ata nuk janë më, se morën dënimin), ish-nëndrejtorin dhe ish-kryeinxhinierin, që s'lanë gjë pa bërë në Portin e Durrësit; këtë unë s'mund ta pranoj.

Më falni për revoltimin. Tani po flas për këto problemet e tjera.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jam vënë në dijeni të projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit tim, {...} si gjyqtar, duke mos qenë dakord me vlerësimin dhe kriterin e “Aftësisë profesionale” – “Mirë” dhe me vlerësimin e përgjithshëm “Mirë”, po paraqes kundërshtimet e mia në lidhje me vlerësimin për këtë kriter, duke shprehur në një vlerësim më të drejtë nga ana juaj. Në të gjithë dosjet që janë tërhequr dhe vlerësuar është konkluduar se seancat gjyqësore kanë rezultuar produktive, gjykimi ka mbaruar brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (se jam marrë me gjykimet penale dhe vetëm tre vitet e fundit jam marrë edhe me penale edhe me civile dhe më përpara me penale. Tani dëgjova që paskam bërë unë “marrëdhënie në punë”. Mund të ketë qenë një çështje, në qoftë se ka qenë. E di që kam pas një çështje tjetër, se jam marrë komplet vetëm me çështjet penale), çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar brenda afateve të

shkurtra, pra brenda afatit procedural 15–ditor të parashikuar sipas nenit 342/2 i K.Pr.Penale. Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancave janë të qarta, referon bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajtjen dhe arsyet e vendimmarrjes. Dosjet janë të plota dhe renditja e akteve e rregullt sipas datave që përmban. Vendimet e arsyetuara përmbajnë elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.Penale. Dispozitivi është i qartë dhe në përputhje me pjesën arsyetuese të vendimit, etj.

Në lidhje me evidentimin e faktit se gjyqtari identifikon konfliktin, bazën ligjore, analizën e fakteve të çështjes që arrijnë në një konkluzion të drejtë, por nuk bën një analizë të ligjit të zbatueshëm, as nuk referon në praktikën gjyqësore, ën vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në vendimet e Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, parashtroj këto pretendime.

Këto gjetje vijnë në kundërshtim me gjetjet në projektraport, siç është qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, zgjidhja drejt e çështjeve, pranimi nga palët i zgjidhjes së çështjes, duke identifikuar faktin se përgjithësisht vendimet e gjyqtarit nuk ankimohen.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj se vendimet unë si gjyqtar i arsyetoj për palët që janë në proces me qëllim që ata të kuptojnë se përse është marrë ky vendim, me qëllim që ata të pajtohen me vendimin si zgjidhje e drejtë e çështjes. Vendimet nuk i arsyetoj për profesionistët e së drejtës, pasi nëse do i bëja të tilla, do i ngarkoja me doktrinë, ato nuk do kuptoheshin qartë nga palët në proces.

Këto vendime të shqyrtuara dhe vlerësuara, janë vendime të shkallës së parë dhe gjithmonë unë si gjyqtar mbaj parasysh në dhënien e këtyre vendimeve jurisprudencën gjyqësore, praktikën e krijuar në lidhje me çështjet dhe faktet e çështjes në shqyrtim, ligjin që aplikohet tek këto fakte, marrëdhëniet juridike që mbron dispozita të cilat janë shkelur mbi faktet objekt gjykimi. Gjithmonë në marrjen e vendimeve kam pasur në konsideratë vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore dhe parimet e parashikueshmërisë së normës, uniformitetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, parimet e humanizmit dhe parimet e përgjithshme për një proces të drejtë e të rregullt. Vendimet e mia jepen në përputhje

me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut. Ky fakt është i provuar tashmë, pasi vendimet janë lënë në fuqi, në të kundërt do të ishin prishur nga gjykatat e shkallëve më të larta që kanë shqyrtuar vendimet e mia.

Në formimin tim juridik, vendimi duhet të jetë i drejtë, i bazuar në fakt dhe në ligj, i kuptueshëm nga palët në proces, me qëllim që ata ta kuptojnë dhe të pranojnë vendimin duke shtuar kësisoj besimin tek publiku dhe drejtësia.

Nëse vendimi do të arsyetohej duke përdorur jurisprudencën e gjykatave, terminologjinë e maksimave latine, interpretimin e instituteve të së drejtës që kuptohen vetëm nga profesionistët e fushës, ose që janë objekt studimi për studentët e së drejtës, vendimi do të zgjatej e do të zgjerohej pa fund dhe do të flitej shumë më pak për faktet e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm. Palët as do ta kuptonin vendimin dhe arsyen e marrjes së këtij vendimi e për pasojë nuk do të ishin dakord me një arsyetim të atillë të vendimit.

Në logjikën time juridike, shqyrtimi i vendimit të ankimuar në shkallën e parë nga gjykatat më të larta në hierarkinë e gjyqësorit, të cilët japin një vendim jo vetëm për palët në proces por edhe për gjyqtarin që ka dhënë vendimin e ankimuar, kanë detyrimin ligjor të verifikojnë se vendimi i dhënë është në përputhje me ligjin, me faktet duke përfshirë në arsyetim edhe përputhjen e vendimit të ankimuar me vendimet e Kolegje të Bashkuara dhe të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore, me parimet e parashikueshmërisë së normës dhe sigurisë juridike, me vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykatat më të larta, sidomos kur prishin vendimin e shkallës së parë, duhet të marrin në analizë edhe institutet e të drejtës për të mbështetur vendimin e tyre në prishjen e vendimit si dhe çfarë duhet të bëjë gjykata e shkallës më të ulët, ashtu siç duhet të bëjë gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë kur prish dhe anulon vendimin e prokurorit të çështjes, duhet t'i tregojë atij se çfarë veprimesh duhet të kryejë; Prishet ky vendim për këto arsye dhe duhet të kryeni këto veprime (një, dy, tre, katër, pesë). Kështu bëhet vendimet.

Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, sjell në vëmendjen tuaj se unë si gjyqtar kam shqyrtuar vendimet e huaja të cilat kërkohen dhe njihen nga gjykatat tona, vendime që vijnë nga vende të ndryshme të zhvilluara, të civilizuara (siç tha edhe relatorja), me një traditë të së drejtës së hershme (bile edhe kam gjykuar jashtë shtetit,

në Londër, sa për dijëni), kam gjykuar dhe mund ta merrni dosjen ta shikoni, për një vrasje të ndodhur nga një i pandehur i Durrësit në mes të Londrës, dhe shikojeni atje. E pashë atje se si thirreshin/merreshin provat dhe të gjitha, sepse kam ndenjur një javë atje duke marrë provat), vende të cilat kam huazuar dhe vazhdojmë të huazojmë legjislacionin dhe praktikën gjyqësore si referencë dhe enë asnjë rast në arsyetimin e këtyre vendimeve nuk kam hasur një arsyetim të tillë të vendimit siç më parashtrohet mua në këtë projektraport, por vendimet janë të arsyetuara me një gjuhë të qartë, të kuptueshme për palët në proces dhe të pangarkuara me praktika gjykatash e vendimesh të tjera të marra nga palë të tjera dhe asnjëherë me interpretime të zgjeruara të instituteve të së drejtës, interpretime të cilat nuk thonë asgjë për palët në proces pasi do të krijonin vetëm konfuzion dhe paqartësi për ta.

Në lidhje me interpretimin e katër elementëve të veprës penale kam përmendur pikërisht këtë fakt, se në praktikën e vendeve gjermanike, se unë kam hasur vendime të Gjermanisë, është hequr dorë nga interpretimi tradicional i katër elementëve të veprës penale, por trajtohen dy elementët: mendimi kriminal që ka të bëjë me fajin dhe që është qëndrimi psikik ndaj veprimit apo mosveprimit të kundraligjshëm dhe veprimi dhe mosveprimi kriminal që ka sjellë pasojën duke garantuar edhe lidhje shkak-pasojë të veprës penale. Këto dy elementë përfshijnë edhe dy elementet e tjera. Gjithashtu dua të sjell në vëmendje edhe praktikën e vendeve të Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, meqenëse siç ju thashë kam gjykuar në Britaninë e Madhe edhe një çështje, një vrasje të ndodhur atje nga një shtetas shqiptar. Prandaj them që vendimet duhet të jenë të arsyetuara, të qarta, pa përmendur arsyetimin e vendimeve të tjera. Pra në dhënien e vendimeve unë përpiqem të mbaj parasysh aq sa mundem edhe këto praktikat e këtyre vendeve që ne aderojmë të bëhemi pjesë, duke përshtatur legjislacionin në përgjithësi.

Kërkoj që të merret parasysh fakti që treguesi për numrin e çështjeve të gjykuara gjithsej nga 1242 është dy herë më lart sesa norma e lejuar që duhet të gjykojë gjyqtari për çdo vit për periudhën 2013 – 2016, se po të jetë për tani, në vitin 2021 kam gjykuar (sa për dijëni) 1000 çështje, në vitin 2022 – 1100 çështje, dhe konkluzioni del vetë. Si mund të gjykojë një gjyqtar 1100 çështje për vitin 2022?! Janë statistikat. Në 2021–in

– 986 çështje (gati 1000 çështje) të përfunduara, të arsyetuara. Mbi 500 çështje kam në dorë. Po të kisha bërë unë normën time 250 çështje, unë do kisha sot 1500 çështje në dorë. Kjo tregon angazhimin tim maksimal në përfundimin dhe në kohë të gjykimeve dhe arsyetimeve të gjykimeve.

Kërkoj të mbahet parasysh nga ana juaj edhe fakti që vendimet e shqyrtuara nga ana ime janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta dhe kanë marrë formë të prerë (siç thashë edhe më lart), fakt që tregon se është një tregues që tregon që aftësitë e mia profesionale janë shumë të mira.

Po kështu kërkoj të mbahet parasysh edhe fakti se detyrimi ligjor imi është që vendimi duhet të përmbajë elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit, si parashikon neni 383 i Kodit të Procedurës Penale, gjë e cila me të drejtë është konstatuar se këto vendime të marra në shqyrtim i plotësojnë këto kritere për një vlerësim profesional shumë të mirë.

Unë si gjyqtar kam pasur dy vlerësime, siç e thashë, një për vitin 2005–2006 (“Shumë mirë”) dhe një tjetër 2007–2009 (“Shumë mirë”).

Po kështu ju parashtoj edhe faktin, se është e vërtetë ajo që tha relatorja, se në dosjen time gjendet diploma dhe lista e notave që kam përfunduar drejtësinë në vitin 1980 me 9.7 (*e korrigjon 9.6*), gjë që tregon aftësitë e mia profesionale dhe teorike, dhe praktike, sepse kam 43 vjet dhe s’kam marrë asnjë masë disiplinore deri më sot, as kur isha në hetuesi, as kur isha në prokurori dhe as tani.

Për shkaqet që paraqita më lart, unë e kam parë të arsyeshme cili është shkaku që e kam pas të arsyeshme që të arsyetojë vendimet në këtë formë. I arsyetojë në këtë formë sepse, mendimi im është se, vendimi duhet të përmbajë provat, analizën e provave, lidhjen e provave sepse njerëzit dënohen mbi bazën e fakteve dhe provave. Në qoftë se në vendim tregohen provat, faktet, mënyra e veprimit, mekanizmi i ngjarjes dhe këto përbëjnë vepër penale, atëherë duhet dënuar njeriu. Njeriu nuk dënohet duke shkruar në fillim të vendimit tre faqe për kompetencën, në mes të vendimit ose më mbropa 30 faqe për përgjimet, duke shkruar aty lloj e lloj citatesh. Se unë për shkak të delegimeve që më keni çuar, kam katër vjet që gjykoj në krimet e rënda dhe kam parë aty vendim në formë libri, 120 faqe vendimi. Atë nuk e lexojmë dot ne, do 1 vit, jo ta lexoj i pandehuri.

Përgjim në datën “kaq”, tre faqe përgjim. Ai çfarë s’ka folur, se llumi i shoqërisë, çfarë nuk flasin. Aty flasin për njerëzit e vet. Si është filania, si është filania, e shkruajnë aty në vendim, që nuk kanë asnjë lloj lidhje me çështjen. Në vend që të përcaktohet që në këtë bisedë ajo që ka vlerë për çështjen është kjo fjali. Në datën “kaq” nuk ka folur, janë këto dy fjali. Në faqen kaq kur ka folur, janë tre fjali. Merrini vendimet dhe shikoni. Unë kam qenë edhe relator atje tek disa çështje. Merrini vendimet e mia që kam dhënë atje dhe shikojini, janë të atilla apo s’janë të atilla? Sepse të shkruash aty budallallëqe (më falni për shprehjen) që flasin njerëzit...

Brikena Ukperaj: Të lutem, se po interferojmë për gjyqtarë të tjerë. Ju lutem!

{...}: Një minutë! Prandaj duhet të jemi më korrekt. Këtë them.

Tani do ju sqaroj vetëm një çështje.

Në datën 2 qershor, ju lexoj faktin, ju lexoj referimin tek gjykatat dhe pastaj të shikojmë Ky është shumë mirë... Dy minuta punë kam.

Më datën 31.05.2023 shtetasja {...} është konstatuar nga patrulla e policisë në Durrës, në rrugën “Taulantja”, vendin e quajtur “filan”, është përfshirë në aksident ku ka pasur dëme materiale dhe nga verifikimi ka rezultuar se është pa leje drejtimi. Në bazë të kësaj, policia gjyqësore ka kryer arrestimin në flagrancë. Këtu tani nxjerrim. Këtu nuk merret vesh se kush është kjo zonja. Nga është kjo zonja.

Për interpretim.

Brikena Ukperaj: Çfarë vendimi është ky?

Për kë vendim bëhet fjalë?

{...}: Do kaloj.

Më poshtë, në vazhdim flitet: Në lidhje me dyshimin e arsyeshëm (është caktim mase sigurimi).

Brikena Ukperaj: Shiko, zoti Rexhep më fal që të ndërpres.

Jo, jo, se nuk mund të flasësh për vendime të gjyqtarëve të tjerë.

{...}: Jo, nuk është e imja. (*E ripërsërit*).

Një minutë!

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut...

Ilir Rusi: Ju lutem tani, zoti {...}.

{...}: Edhe një minutë.

Ilir Rusi: Të lutem, nuk është çështja e kohës.

Gjyqtar {...}, ju lutem!

Zoti {...} flet mbi zotin Rusi duke përmendur precedentë çështjesh kundër Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Budinov kundër Bullgarisë, duke vijuar: Për një drejtim mjete pa patentë të një gruaje të ardhur nga Prishtina e Kosovës, që kishte zënë një vend aty në hotel bashkë me një shoqen e vet; shoqja e vet kishte patentën (lejen e drejtimit). Shkuan aty në një lokal, 300 metra më tutje. Ajo shoqja që kishte lejen e drejtimit piu dy birra; i tha nuk e drejtoj dot më tani makinën; e mori kjo tjetra për ta çuar deri tek hoteli; e kapi policia.

Ilir Rusi: Zoti gjyqtar, ajo çfarë ju po parashtroni...

{...}: Unë nuk kam asnjë gjë me relatoren, por unë konstatoj dhe vlerësoj që vendimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe të jetë në analizë provash dhe faktesh për çfarë ka ndodhur. Po s'u analizua çfarë ka ndodhur, çfarë vërtetohet, si vërtetohet, mekanizmi i ngjarjes, e të gjithë, nxjerrim edhe faktin e ka bërë me dashje, e ka bërë me dashje indirekte, me dashje direkte, apo nga pakujdesia. Vetëm kështu dalin këto gjëra. Unë kështu e mendoj, prandaj unë shpresoj që kundërshtimet e mia nga ana juaj të merren parasysh. Nuk kam vërejtje për këto të tjerat që thotë "Shkëlqyeshëm",

"Shkëlqyeshëm", "Shkëlqyeshëm" (për tre kriteret e tjera), por këtej "Mirë", këtej tre herë "Shkëlqyeshëm" dhe unë të vij të diskutojmë për 2016–ën për këtë ish–drejtorin, ish–zëvendësdrejtorin dhe kryeinxhinierin, kjo është...

Zonja relatore ju e patë aty që për kë bëhesh fjalë. E ke lexuar që bëhesh fjalë për ish–drejtorin e portit, për ish–zëvendësdrejtorin, për ish–kryeinxhinierin.

Brikena Ukperaj: Vendimi juaj ka qenë një vendim moskompetence. Nuk kanë qenë absolutisht përmendur këto që ju thoni, e para. E dyta, në vendimet gjyqësore, për efekt të etikës që unë ruaj në vlerësim nuk referojmë çështjen. Zgjidhjen e çështjes, mënyrën e zgjidhjes e shikoni ju. Ne shikojmë mënyrën e sjelljes së gjyqtarit gjatë gjykimit të një çështjeje. Sot i shpjeguat arsyet.

{...}: Unë mendoj kështu, sepse në praktikë ndodhin këto gjëra. Ndodhin këto gjëra në praktikë. Tani ai ku do ankohej. S'la vend pa u ankuar. Çfarë t'i bëja unë?

Ilir Rusi: Zoti {...} parashtruat kundërshtimet tuaja dhe qëndrimet tuaja.

Do ftoja anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse kanë ndonjë pyetje apo jo.

(Nuk ka pyetje.)

Meqenëse nuk kanë pyetje, zoti {...} mund të vazhdoni dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vazhdojë me trajtimin e rastit tuaj në vijueshmëri.

Mund të vazhdoni!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Pas paraqitjes së kundërshtimeve nga zoti {...}, duke marrë në konsideratë edhe atë çfarë relatorja tha në moment të relacionit të saj në lidhje me zotin {...} si gjyqtar, ftoj anëtarët nëse kanë diskutime apo jo.

(Nuk ka diskutime.)

Për sa nuk ka diskutime nga anëtarët pas parashtrësive/kundërshtimeve nga ana e

gjqtarit {...}, do të ftoja relatoren për të bërë propozimet në vijim të asaj çfarë tha kur përfundoi relacionin e vet.

Po, zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në fakt, edhe pasi dëgjova kundërshtimet e gjyqtarit, në cilësinë e relatores nuk kam propozime të tjera për Këshillin veç atyre që kam pasqyruar në projektraportin e vlerësimit. Dua të theksoj se çështja që gjyqtari iu referua, aspak nuk ka të dhëna për palët në dosje, sepse vendimi sikur thashë është një vendim moskompetence dhe i gjithë konkluzioni im bazohet pikërisht në raportin që kanë përgatitur ish-inspektorët, që është përgatitur nga organet e rivlerësimit dhe nga analiza e mëtejshme që kam bërë referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me rastet se kur duhet të caktohet një mbrojtës kryesisht dhe veprimet që duhet të kryejë gjyqtari kur prokurori në mënyrë të përsëritur nuk paraqitet në seancë gjyqësore, pavarësisht qëllimit apo mekanizmave që kanë pasur palët në rastin konkret.

Për sa i përket pretendimeve të ngritura lidhur me kriterin e parë të “Aftësive profesionale”, pretendimet e ngritura në tërësi, në fakt unë dua të theksoj që procesi i vlerësimit etik dhe profesional është një proces që bazohet mbi baza dokumentare. Pra pavarësisht dijeve të gjyqtarit, ne vlerësojmë gjyqtarin referuar akteve procedurale që ai prodhon dhe referuar këtyre akteve procedurale që ai prodhon ai vetë e pranon që ka këtë mënyrë të shkruari të vendimeve, dhe pse jo, vlerësimi etik dhe profesional në vlerësimin tim duhet të jetë ai i cili ta motivojë gjyqtarin, ta ndryshojë edhe mënyrë e të shkruarit të vendimit. Është e vërtetë që vendimi është i qartë se çfarë shkruan, por vendimi nuk është i qartë për palën që pse u dënova për këtë vepër dhe nuk jam dënuar për një vepër tjetër që unë e kam ngritur pretendimin; ose pse pranohet padia dhe nuk pranohet pretendimi i palës tjetër për rrëzimin e padisë. Pra kjo lidhet jo vetëm me gjithëpërfshirjen por lidhet edhe me mënyrën se si palës duhet t’ia tregosh ligjin dhe duhet t’ia interpretosh ligjin. Unë jam dakord që vendimet nuk mund të mbingarkohen me doktrinë, me jurisprudencë, shpeshherë dhe jo relevante për sa i përket zgjidhjes së çështjes, por ligji i cili është ligji bazë që zgjidh mosmarrëveshjen mes palëve, duhet jo vetëm të citohet por edhe të

interpretohet, që pala të kuptojë pse më ke kualifikuar tek kjo dispozitë dhe nuk më ke kualifikuar tek ajo që unë mendoj që në fakt unë duhet të deklarohej me një masë dënimi më të ulët apo duhet të marrë ndoshta edhe pafajësi.

Kjo ishte gjithë analiza.

Për këtë arsye unë vlerësoj që nuk kam për të bërë asnjë propozim të ndryshëm nga ajo që kam propozuar. Përfundimisht i mbetem të njëjtit propozim. Lidhur me nivelin e vlerësimit përfundimtar “Mirë”. Për kriterin e “Aftësive profesionale”, niveli i vlerësimit “Mirë”, 63 pikë. Për kriterin e “Aftësive organizative”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, 94 pikë. Për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” vlerësimi “Shkëlqyeshëm”, 100 pikë. Për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 91. Në total niveli i vlerësimit është “Mirë” dhe pikët janë 348.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime nga anëtarët pas përmbledhjes dhe prezantimit fundor të relatimit të bërë nga zonja Ukperaj?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Mirë”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kushtet kur materiali prej një kohe të arsyeshme është vënë në dispozicion, po e jap në formë sintetizore përmbajtjen e saj. Me vendimet nr. 11 – nr. 24, 18.01.2023, nga ana e KLGJ-së janë hapur disa pozicione të lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës, ndër to edhe me vendimet nr. 11 dhe nr. 20 që i përkasin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Një nga kandidatet ka qenë zonja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, aktualisht gjyqtare e transferuar për një periudhë 1–vjeçare pranë Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për të janë bërë disa akte procedurale të cilat synonin të evidentonin vlerësimin etiko–profesional si dhe plotësimin e kushteve formale. Po citoj disa:

Me vendimin nr.77, datë 13.02.2023 nga ana e Këshillit është miratuar lista e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë.

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit ndër to edhe për zonjën {...}.

Me vendimin nr. 187, datë 25.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është procedurat me kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që, më datën 17.05.2023 nga ana e zonjës {...} është përcjellë nëpërmjet komunikimit elektronik një kërkesë ku ajo shpreh vullnetin për t’u tërhequr nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023.

Në kushtet kur vullneti i gjyqtarit është një nga parashikimet kur kandidimi ndërpritet parashikuar në pikën 29, Seksioni Ç, Kreun IV, si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020, nga ana e relatorit është përpiluar projektvendimi në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të

shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile,

të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Më lejoni ta paraqes po në formë të sintetizuar edhe këtë material. Zoti {...} është një nga kandidatët të cilët ka kandiduar për procedurat e lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pozicionet e lira nr. 16 dhe nr. 18, 18.01.2023. Edhe për këtë kandidat janë kryer disa veprime procedurale nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku evidentohet vendimi nr. 77, datë 13.02.2023, me anë të të cilit Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt kandidimi për procedurat e shpallura të lëvizjes paralele.

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023 filloi procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, ndër to edhe për këtë kandidat.

Me vendimin nr. 186, datë 25.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur kualifikimi i kandidatit {...} dhe vijimi i procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 16 dhe nr. 18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që në datën 29.05.2023 nga ana e z. {...} është paraqitur një kërkesë me anë të së cilës (citoj): “Deklaroj se tërhiqem nga kandidimi im në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023”.

Siç cituam edhe për kandidaten e mëparshme, vullneti i gjyqtarit për t’u tërhequr përbën një nga figurat e parashikuara në rregulloren nr.320/2020 të KLGJ-së, kështu që në këto kushte, nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura

me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Me vendimet nr. 499, 500, 501, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për këto tre vende të lira vakante të shpallura, ka shprehur interesin edhe zonja {...}. Pasi është paraqitur kërkesa e saj Komisioni ka filluar verifikimet dhe përpara Këshillit po paraqesim rezultatet e verifikimit paraprak për kriteret e kandidimit të saj.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022.

Për verifikimin e kandidate në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale (referuar sa më sipër), duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009, ndërkohë që ajo është emëruar si magjistrate pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (gjatë periudhës së stazhit profesional) për periudhën 07.01.2009 deri në qershor 2010, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec e më pas është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku vijon të ushtrrojë funksionin dhe aktualisht.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, rezulton se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datë 05.07.1998 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009.

Me dekretin nr. {...}, datë 07.01.2009 të Presidentit të Republikës caktohet për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 25.06.2010 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Me vendimin nr. {...}, datë 03.05.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i jepet leje për të shërbyer si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë 3-vjeçare.

Me vendimin nr. {...}, datë 20.12.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. {...}, datë 27.05.2016 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas përfundimit të afatit të shërbimit si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, kthehet në vendin e punës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjstrates është 14 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e përmendura më lart, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për znj. {...} rezulton se për janar – dhjetor 2016, ndërmjet të tjerave rezulton se ka gjykuar gjithsej 2 kërkesa penale.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec për kandidaten rezulton se znj. {...} me dekretin nr. {...}, datë

25.06.2010 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Për periudhën 2010 e në vijim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (seksioni civil/seksioni penal), por ka funksionuar e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile e penale. Referuar të dhënave statistikore që administrohen në gjykatë, evidencat e ngarkesës së gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për vitet 2010–2013, rezulton se gjyqtare {...} për këtë periudhë ka gjykuar nga të gjitha llojet e çështjeve.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, për kandidatin rezulton se: "...me vendimin nr. {...}, datë 03.05.2013 të KLD-së "Mbi dhënie leje gjyqtares {...} për të shërbyer si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë " është angazhuar si ndihmëse ligjore pranë Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ku ky i fundit ishte kryetar i kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë. Në sqarimet e saj kandidatja ka parashtruar se: "Kam vlerësuar se plotësoj kriteret e kësaj vjetërsie për shkak se:

"Kam ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Pogradec nga muaji qershor 2010 deri në muajin maj 2013. Në këtë gjykatë nuk ka pasur seksione të ndara, kështu që objekt i punës time kanë qenë edhe çështjet penale.

Nga muaji maj 2016 deri në korrik të vitit 2017, edhe pse kam qenë në seksionin civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam shqyrtuar kërkesa për caktimin e masave të sigurimit ndaj të arrestuarve.

Ndërkaq, në periudhën maj 2013 – maj 2016 kam siç e keni konstatuar edhe ju, kam qenë në funksionin ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë (pas ndryshimeve ligjore ndihmësmagjistrat). Për shkak të rregullimit të ndryshëm ligjor, në atë periudhë, ndihmësit ligjor ishin të caktuar pranë një gjyqtari, e konkretisht unë kam qenë gjatë gjithë periudhës ndihmëse ligjore e gjyqtarit z. {...}.

Pavarësisht se z. {...} gjatë periudhës së mësipërme, ka qenë pjesë e Kolegjit Administrativ të asaj gjykate, kam vlerësuar se tre vitet e përvojës time si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë do të duhet të llogariten si eksperiencë lidhur me aplikimin tim për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme kundër Krimin dhe Organizuar dhe Korrupsionit, për arsye se:

Së pari, mendoj që, eksperiencia e posaçme penale kërkohet në kushtet kur magjistrati ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe jo kur magjistrati ka ushtruar detyrën si ndihmësmagjistrat i komanduar, pavarësisht se ku është ushtruar detyra. Kam paraqitur aplikimin duke vlerësuar se edhe periudha e ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Lartë, do të përlllogaritet si eksperiencë e posaçme për secilin pozicion që kërkohet ngritja në detyrë.

Së dyti, nisur nga fakti që kam qenë ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, kam përgatitur projektvendimet lidhur me kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve penale (pasur parasysh nenin 417 të K.Pr.Penale); kam përgatitur relacione të veçanta sa herë që gjyqtari z. {...} ka marrë pjesë në gjykimin e çështjeve penale, pavarësisht se në fashikullin e asaj gjykate kishte relacion të ndihmësit të gjyqtarit relator të çështjes; kam përgatitur relacione të veçanta të drejtuara gjyqtarit, ndihmëse ligjore e të cilit isha, lidhur me të gjitha çështjet e shtruara në Kolegjet e Bashkuara nga ana e Kolegjit Penal të kësaj gjykate. Në të gjithë rastet vetëm ose në bashkëpunim me ndihmësen tjetër ligjore, është përgatitur relacion në lidhje me praktikën gjyqësore të deriatëhershme, problemet apo kundërshtitë në zbatimin e ligjit, praktikën e GJEDNJ-së në lidhje me çështje të caktuara, si dhe kërkim në legjislacione të huaja. Këto relacione nuk mund t'i paraqes, pasi nuk janë përfshirë në fashikullin e gjyqimit të atyre çështjeve, pasi kishte gjyqtarë të tjerë që ishin relatorë të çështjes dhe ishin relacione të përgatitura për gjyqtarin ndihmëse ligjore e të cilit isha në atë periudhë dhe i shërbenin atij.

Sa më sipër, vlerësoj që plotësoj kriteret e vjetërsisë për efekt të kandidimit tim në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.”

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidatja ka depozituar: Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidatja, znj. {...}, i datës 05.12.2022.

Sa sipër, rezulton se kandidatja, dhe familjarët e saj të afërt, konkretisht vajza, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, nga ku ka rezultuar mbi bazën e verifikimeve të bëra nga ana e Komisionit që deri aktualisht, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë një masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”, datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Shqyrtimi nga Komisioni:

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e përmendura më lart, relatori i çështjes ia parashtrou

rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Më pas, në mbledhjen e datës 31.05.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me propozimet e përmendura më lart dhe janë bashkëlidhur projektvendimit përkatës, i cili përmban tre pika.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Zoti Kurushi, ju falënderoj për relacionin!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e

procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Në lidhje me relacionin e radhës që i referohet zonjës {...}, ajo ka shfaqur interesin për të kandiduar referuar vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor për një hapje të vendit vakant me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor për një pozicion të lirë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nëse kolegët janë dakord, unë po e kaloj në mënyrë shumë telegrafike.

Rezultatet e hetimit për përvojën profesionale kjo kandidatë i plotëson, pra si kriterin minimal ashtu edhe kriterin e përgjithshëm, është mbi 7 vite në detyrë si gjyqtare dhe prej të cilave 5 vite në fushën përkatëse. Ajo ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë ku ka gjykuar në të gjitha llojet e çështjeve, pasi nuk i ka pasur të ndarë seksionet civile ose penale.

Njëkohësisht, nga ana tjetër, referuar kriterit të dhënies së pëlqimit të saj si dhe të familjarëve të vet, mbështetur në ligjin nr. 95/2016, ka rezultuar se kandidatja ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidatja, më datë 05.12.2022. Njëkohësisht edhe formularin e vetëdeklarimit të anëtarëve të familjes së kandidatës, Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshorti i saj, z. {...}, i datës 05.12.2022, kështu që është plotësuar edhe ky kriter me paraqitjen e deklaratave nga familjarët dhe nga vetë kandidatja.

Në lidhje me kriterin e “mospasjes masë disiplinore”, si nga deklarimi i bërë nga vetë kandidatja, ashtu edhe nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar që deri në momentin e verifikimeve të bëra nga ana jonë, kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”, si nga verifikimet edhe nga deklarata e saj, rezulton që kandidatja deri në këto momente nuk ka asnjë arsye për

të menduar se ngritja në detyrë e saj mund të bie ndesh me kriterin e papajtueshmërisë ambientale të saj, si dhe nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Me plotësimin e të gjithë kriterëve të përmendura më lart, pra kriterëve formale ligjore, paraqesim përpara Këshillit relacionin përkatës së bashku me projektvendimin i cili është i strukturuar gjithsej në tre pika.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500 datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura

me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Me vendimet nr. 499, 500, 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë hapur tre vende të lira për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në lidhje me këto vakanca të përhershme lira të hapura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka shprehur interesin edhe znj. {...} e cila ka paraqitur kërkesat e saj për të kandiduar në këto tre vende të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas marrjes së kërkesave Komisioni bëri verifikimet përkatëse për rastin e kësaj kandidateje si dhe kandidatëve të tjerë dhe rezultatet e verifikimit paraparak për kriteret e kandidimit po i parashtrajmë përpara mbledhjes.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”. Në relacion do të gjeni bashkëlidhur përvojën e saj profesionale e cila plotësohet 7 vjet përvoja e përgjithshme profesionale dhe 5 vjet është përvoja specifike minimale profesionale të cilat plotësohen nga përvoja që ka zonja {...} në ushtrimin e detyrës si gjyqtare aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.

Bashkëlidhur janë edhe vitet në të cilat zonja {...} ka ushtruar detyrën dhe ka dhënë kontributin edhe në fushën e së drejtës penale.

Në lidhje me kriterin e dytë të “dhënies së pëlqimit (ajo dhe të afërmit e saj) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, rezulton se znj. {...} ka paraqitur vetëdeklarimin sipas Shtojcës B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidatja, datë 05.12.2022, si edhe nga bashkëlidhur edhe deklarimin e bërë nga bashkëshorti i saj z. {...}.

Në lidhje me kriterin e tretë që i referohet “mospasjes së masës disiplinore në fuqi” që sipas verifikimeve dhe informacionit të përcjellë nga Departamenti i

Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, kandidatja zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi, kështu që edhe në lidhje me këtë kriter, nuk ka probleme që mund të pengonin zonjën {...} për vijimin e mëtejshëm të procedurave për ngritjen e saj në detyrë.

Në lidhje me kriterin e fundit, asaj të “papajtueshmërisë ambientale”, nga verifikimet e bëra si dhe nga deklarimi i dhënë nga vetë kandidatja, rezulton se ajo nuk ndodhet dhe nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë këtij verifikimi për zonjën {...} si dhe nga deklarimi i dhënë prej saj, rezulton se nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes së saj në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Bashkëlidhur këtij relacioni dhe verifikimet e bëra nga Komisioni, ne paraqesim edhe projektvendimin përkatës i cili është i strukturuar gjithsej në tre pika.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.06.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.**
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 6. Edmond Hoxhaj, BIRN.**

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, e cila është pika e fundit për këtë mbledhje plenare, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Me vendimet nr. 501, 502 dhe 504, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me vendimin nr. 501), ndërsa me dy vendimet e tjera hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale dhe në Gjykatën e Apelit Korçë po në fushën e të drejtës penale. Për këto tre pozicione ka kandiduar edhe gjyqtarja {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Duke qenë se të gjithë anëtarëve i është vënë në dispozicion materiali dhe janë të njohur, shkurtimisht pasi janë bërë të gjitha procedurat nga ana e Këshillit është vijuar me rezultatet e verifikimit paraprak për kriteret dhe rezulton që për kandidaten znj. {...} është verifikuar kriteri i përvojës profesionale minimale dhe rezulton që sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, magjistratja znj. {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016. Me dekret nr. {...}, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. {...}, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është caktuar në pozicion për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë kësaj gjykate. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 7 vite e 10 ditë deri në

momentin e aplikimit të kandidates. Pra plotëson kriterin e pasjes mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Gjithashtu nga të dhënat e administruara të cilat nuk po i citoj, rezultojnë që ka përvojën specifike profesionale mbi 5 vjet në fushën e së drejtës penale, pasi sipas urdhrave përkatës të administruara dhe që ndodhen të cituara në projektvendim, e plotëson këtë kriter duke gjykuar nga viti 2016 – 2022 ka gjykuar rreth 1897 dosje penale, seanca paraprake, kërkesa penale, kërkesa ushtarake.

Gjithashtu, nga ana e kandidates, zonja {...} është verifikuar kriteri i dhënies së pëlqimit të kontrollit periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake (nga ajo dhe të afërmit e saj), dhe konkretisht është bashkëlidhur edhe formulari i dorëzuar nga kandidatja znj. {...} si dhe formulari tjetër i plotësuar nga bashkëshorti i saj z. {...}, të cilat janë nënshkruar dhe janë dorëzuar rregullisht.

Më tej është vijuar me verifikimin e kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe rezultojnë nga i gjithë dokumentacioni dhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezultojnë që nuk ka masë disiplinore për magjistratën {...}. Ndërsa për sa i përket “papajtueshmërisë ambientale” bëj me dije se deri në momentin e përgatitjes së këtij relacioni, nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon, megjithëse në të njëjtën gjykatë kandidon edhe bashkëshorti i saj z. {...}, për të cilin nga ana e Këshillit është vendosur me vendimin nr. 266, datë 24.05.2023, dhe është verifikuar “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Pra citoj, deri në momentin e përgatitjes së këtij relacioni, pra deri në këto momente, nuk konstatohet që të kemi një situatë të tillë.

Më vonë pastaj, me kalimin e procedurave të njërës nga bashkëshortët, atëherë besoj që do të krijohet edhe kushti apo pengesa ligjore për njërin nga dy bashkëshortët që të mund të vijojë më tej o me dorëheqjen e tyre, pra me tërheqjen nga kandidimi të secilit apo me përjashtimin nga ana e Këshillit, në varësi të situatës e cila do rrjedhë.

Pra dua të citoj që deri në këto momente nuk ndodhemi në kushtet e qenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, duke plotësuar kriteret e pasjes së “përvojës minimale profesionale”, të “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake”, si dhe të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, është paraqitur relacioni Komisionit dhe ky Komision shprehet për verifikimin e plotësimit të kushteve nga kandidatja dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera të kandidimit.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 501, nr. 502 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin e Këshillit nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, janë trajtuar të gjitha pikat e kësaj mbledhjeje plenare. Mbledhjen e deklarohet të mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor